

VANGJEL LIZA
POEZIA LIRIKE ANTIKE GREKE
SAFO – JETA DHE VEPR

BOTIMET TOENA

VANGJEL LIZA

POEZIA LIRIKE ANTIKE GREKE

SAFO - JETA DHE VEPRAT

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Ana Shema

ISBN 978-9928-235-16-9

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*Babait tim,
me mirënjohje të përhjetshme.*

PËRMBAJTJA

KUADRI EKONOMIK, POLITIK DHE SHOQËROR I GREQISË SË LASHTË NDËR VITE.....	11
Jeta në Athinë.....	11
Lufta sociale.....	17
Jeta kulturore, teatri	24
Jeta në Lesbo. Safoja	37
Eteret.....	44
Safo	51
Perikliu.....	56
 POEZI	65
Lavdërime qiellore.....	67
Flisja në gjumë.....	69
As bletën dhe as.....	71
Jo, nuk jeni ju.....	73
Lajmëtari i Pranverës	75
Ylli më i ndritur	77
Sa yje gjenden atje	79
Mesnata po afrohet.....	81
Dallëndyshes.....	83
Nga qiejt fluturo	85
Afërditë, bijë e Zeusit	88

Këndo ti o Muzë	91
Shoqeve të mia.....	93
Asgjë nuk shkëlqen.....	95
Ah, sikur të ishte.....	97
Vogëlushja që mblidhte lule.....	99
Sa kohë të dashuroj, Attida	101
Ah, kjo dashuria!	103
Do të vijë një ditë.....	105
Kthehu prapë të lutem.....	107
Eja, Girina.....	109
E bukura Dika	111
Nuk të lë unë ty.....	113
Një grua mendjemadhe	115
Mos u mbaj si e veçantë.....	117
Si perëndi fatlume.....	120
Më mirë të kisha vdekur	124
Gjëja më e bukur mbi tokë.....	128
Mendime nga Sardia	132
Himn për Adonin	135
Plot gëzime e mbushur.....	137
Fije bari e venitur.....	139
Urimet për dhëndrin.....	141
Rojtari i të porsamartuarve	143
Molla e pakapshme	145
Diçka dua të të them	147
Një lutje për vëllanë.....	150
Mua më mbrojnë perënditë.....	153
Vajzës sime	155
Jam më e madhe në vite.....	157
Më kujtohet nëna ime	159
Në gjumë m'u shfaq Era	162

Lajmëtari i gëzimit.....	167
Këmbët e saj.....	171
Ëndrra të zymta.....	173
Një djalë i vogël.....	175
Lecka që pikon kudo.....	177
Kruspull nga frika.....	179
Pleqëria të rëndon	181
Gërshetat e mëndafshita.....	183
Atë që vure në mendje	185
Pak përpara agimit.....	187
 KOMENT LETRAR MBI DISA POEZI TË SAFOS.....	189
Shumë shkurt për Alkeun.....	263
Shumë shkurt për Anakreontin	272
Shënime	283
 SHËNIM I AUTORIT.....	309
BOTIME PËR VEPRËN E SAFOS	311
BIBLIOGRAFI	315
 <i>Biografi e shkurtër e autorit.....</i>	319

KUADRI EKONOMIK, POLITIK DHE SHOQËROR I GREQISË SË LASHTË NDËR VITE

Jeta në Athinë

Ndoshta në themel të fatit të jashtëzakonshëm të Greqisë së Lashtë dhe në veçanti të Athinës qëndronte varfëria e saj. Banorët e Athinës nuk do të kishin mundur të zgjidhnin si vendqëndrim të tyre një qoshe më të thatë dhe më pak pjellore të botës. Sepse nga më shumë se të dyqind mijë hektarët e saj, një pjesë më shumë se gjysma është e pakultivueshme, madje deri edhe në ditët e sotme, edhe me zbatimet e teknikës moderne. Kurse gjysma tjetër kërkonte lodhje dhe heroizma që të merreshin frytet tipike të tokave të varfra, si: verën, vajin dhe fiqtë. As edhe veprat e mëdha vaditëse e të kullimit të ndërmarra nga Pisistrati në vitet e mëpasshme nuk mundën të grumbullojnë drithë sa për të ngopur qoftë edhe një të katërtën e popullsisë. Por athinasit nevojën e bënë dhunti dhe mësuan të shfrytëzojnë në maksimum burimet

e tyre të varfra dhe t'i administrojnë ato me kriter e me kursim. Duket si e pamundur, por qytetërimet e përparuara, si sens mase të ekuilibrit dhe të qartësisë mendore kanë gjithmonë për bazë kursimin e tokës. Duke pasur si prodhim bazë vetëm vajin e ullirit, grekët dhanë shpejt idenë e shfrytëzimit të çdo gjëje të mundshme që mund të përdorej në kuzhinë.

Popujt do të mund t'i ndanim në dy grupe të mëdha, në ata që jetonin me vajin dhe në ata që përdornin gjalpin. Nuk ka pikë dyshimi se qytetërimi lindi te të parët. Të kushtëzuar nga kjo varfëri, dieta e grekëve dhe e athinasve në veçanti ishte shumë e përmbajtur, gjë që shpjegon shëndetin e tyre shumë të mirë dhe rezultatet e larta sportive.

Kush ka krijuar një ide nga tregimet e Homerit, se një kec i pjekur për grekët ishte një mëngjes i zakonshëm, po e shpreh kështu në mënyrë popullore, ka dalë jashtë rrugës. Në Athinë vetëm të pasurit hanin herë pas here mish. Dhe nëse peshku i kripur ishte më i zakonshëm, ai i freskëti përbënte një ushqim të shtrenjtë. Fshatarët nuk hanin veçse drithëra, thjerrëza, bathë, bizele, fasule, qepë, lakra, erëza dhe hurdha. Vetëm në ditët e festave, ku e ku, i këpusnin qafën ndonjë gjeli dhe përgatisnin ndonjë ëmbëlsirë me vezë dhe mjaltë, sepse të gjithë ishin pularritës dhe bletërritës. Por edhe qytetari i mesëm nuk largohej shumë nga ky regjim. Dhe Hipokrati, mjeku që themeloi mjekësinë, thërriste i skandalizuar: “Dhe të mendosh se ka njerëz që hanë edhe dy, dhe tri herë në ditë dhe këtë gjë e quajnë normale!”.

Më mirë shkonte puna në industrinë nxjerrëse. E para ishte ajo e kripës, që për njëfarë kohe vlejti edhe si monedhë shkëmbimi. Kaq e vërtetë është kjo, saqë për të lavdëruar një mall të mirë zakonisht thuhej: “Ja vlen kripën e tij!”. Si lëndë djegëse athinasit përdornin drurin dhe ishte për të keqen e tyre, që me disa të rëna të sëpatave i rralluan e prishën edhe ato pak pyje që i rrethonin.

Dhe Perikliu kur erdhi në pushtet gjeti një Athinë të rrethuar nga një det me gurë, që edhe për drutë ishte e varur nga importimi i tyre. Gjeologët e tij kërkuan në kthinat e tokës për të nxjerrë argjend, hekur, zink, kallaj dhe mermer. Pikërisht kur ai mori fuqinë në dorë, Athina ishte përfshirë nga ethet e argjendit, për shkak të disa damarëve të pasur që ishin gjetur në Lavrio. E gjithë nëntoka i përkiste shtetit, por nuk i shfrytëzonte minierat drejtpërsëdrejti ai vetë. Ua jepte në përdorim privatëve me kontratë që i paguanin çdo vit shtetit një sasi parash, plus një përqindje nga prodhimi dhe i shfrytëzonin me punën e skllevërve. Prej syresh në shekullin e pestë kishte rreth njëzet mijë të punësuar të tillë në kondita pune të padëguara. Sipërmarrësit i merrnin me qira nga grosistët për njëqind ovollo në ditë. Dhe natyrisht me paga të këtij niveli, përfitimet ishin të mëdha. Në bilancin e parë shtetëror të Perikliut rezultoi se ata përbënin një nga kontribuesit më të mëdhenj në arkën e shtetit.

Përpunimi i mineralit siç mund të kuptohet ishte primitiv, por njihnin mirë havanët e mëdhenj shtypës, filtrat dhe larjet. Dhe rezultatet duhej të ishin të çmuara sepse, për shembull, monedhat e argjendit ishin të pastra deri në nëntëdhjetë e pesë për qind, pothuaj njëlloj si edhe në ditët e sotme dhe artizanati i Athinës ishte ndër më të mirorganizuarit dhe ndër më të famshmit për perfeksionin e prodhimeve të tij. Kështu për shembull, ai që prodhonte shpata nuk prodhonte mburoja dhe anasjelltas, sepse secila nga këto specialitete ishte një monopol i veçantë i shoqërive të armëpunuesve. Kuptohet që këtu nuk bëhej fjalë për komplekse të vërteta industriale, por për rrugë me dyqane të pafund në të dy anët, njëlloj si ka qenë vargu i dyqaneve në pazarin e vjetër të Tiranës apo atij të Korçës, ilustrim ky për ata që i mbajnë mend, ku secili prej tyre ishte xheloz për pavarësinë e tij dhe me skllevërit në vendin e punës në vend të makinave. Të gjithë qytetarët më në zë të Athinës ishin pak industrialë, aq sa secili posedonte një ose

më shumë nga këto dyqane. Edhe Perikliu, edhe Demosteni ishin pronarë. Dhe kjo pati rëndësinë e saj sepse një popullsi me karakter kryesisht industrial përfundon gjithmonë në zbatimin e një politike të ndryshme nga ajo e popujve me karakter fshataro-bujqësor. Së pari, sepse ajo tenton t'u japë përparësi problemeve të tregtisë dhe të financës. Për të kompensuar importet e prodhimeve ushqimore, athinasit duhej të kujdeseshin për eksportimin e prodhimeve të tyre artizanale, domethënë të një prodhimi mjaft të madh. Ja pse qytetërimi athinas ishte thellësisht i zgjedhur dhe qytetar. Nëse do të ishte shtrirë me proporcionet dhe burimet e qytetit të vjetër, Athina do të kishte mbetur një qytet pak më i madh se një qytet i vogël. Për t'u bërë një kryeqytet nuk i mbetej gjë tjetër veçse të zhvillonte sa më shumë artizanatin industrial, që i siguronin tregje të jashtme. Por këto nuk mund të gjendeshin në territoret e thella greke për vështirësi të komunikacionit. Athinasit nuk ishin ndërtues të mëdhenj të rrugëve siç ishin latinët. Ndërtuan vetëm një, Rrugën e Shenjtë deri në Elefsina, por edhe atë, duke parë se nuk kishte leverdi sepse përfitimet nuk i mbulonin shpenzimet, as nuk e përfunduan së shtruari me pllaka guri. Por ama u mbetej deti. Dhe Athina me Pireun në një distancë pak më shumë se dymbëdhjetë kilometra ishte edhe më e volitshme se Tirana me Durrësin. Pastaj Salamina ishte padrone e Mesdheut Lindor. Flota e saj kishte anije me tonazh përmbi dyqind tonelata dhe me shpejtësi përmbi pesëmbëdhjetë kilometra në orë, me skllëvër në rrema dhe vela për erën. Ishin anije për ngarkesë por transportonin edhe pasagjerë, tarifa e të cilëve varionte nga pesha personale dhe e bagazheve që kishin, sepse trajtoheshin si thasë drithi ose patatesh. Duhej të merrnin me vete diçka për të ngrënë gjatë rrugës, sepse nuk parashikohej as ushqimi, as vende për t'u ulur. Por çmimet ishin të ulëta dhe me një sasi të vogël drakmesh mund të shkonin deri në Egjipt.

Çështja më e rëndësishme për t'u rregulluar ishte sistemi monetar dhe bankar, dhe këtu Athina kuptoi atë që romakët më pas nuk mundën ta kuptonin kurrë, domethënë mënyra e vetme për të qenë dinakë ishte ajo që të mos jesh. Ndërsa të gjitha shtetet e tjera praktikonin dinakërinë e ulët të zhvleftësimit, ajo zbatoi një ndershmëri që nuk ishte në zakonet dhe në moralin e qytetarëve të saj, duke i dhënë drakmës një vlerë të qëndrueshme, njëlloj si të themi sot, të frangut zviceran apo të dollarit amerikan, duke e bërë kështu monedhë të shkëmbimit ndërkombëtar. Një drakme, e shkruaj kështu në variantin e saj antik, përbëhej nga gjashtë ovollo dhe secili, me sistem të përafërt krahasimi, vlente le të themi rreth njëqind lekë të reja, dhe përmbante një sasi të caktuar argjendi që nuk ndryshoi kurrë. Kurse të kombinoje biznese në cilëndo monedhë tjetër, kishte rrezikun të përfundoje në atë ku përfunduan njerëzit tanë me sistemet financiare piramidale. Me drakmën të gjithë ishin të qetë. Në çdo vend të botës që të shkonin, fuqia blerëse e saj ishte e përcaktuar: një trastë e mbushur plot me grurë.

Duke qenë metalike, nuk ishte e lehtë të transportohej. Por pikërisht për këtë lindën bankat, historia e të cilave na lejon që të masim hipokrizinë e athinasve dhe pafundësinë e marifeteve të tyre. Ata e konsideronin imorale dhënien e borxhit me interes, dhe përreth një shekull i detyruan kursimtarët t'i fshihnin paratë e tyre në çorapet e leshit. Më pas u kujtuan që këto kapitale i hiqeshin qarkullimit produktiv. Dhe atëherë, edhe pse vazhduan t'i ndalonin bankat, lejuan që kursimet të depozitoheshin nëpër kisha. Kuptohet që, kur dikush për shembull ia besonte për herë të parë shumën e tij perëndeshës Athina Palladës, nga pikëpamja morale ishte në rregull. Dhe për sa i përket Palladës, ajo ishte e lirë të bënte çfarë të donte me ato para, edhe t'ia jepte borxh ndonjë besimtari nën detyrimin që t'i kthente mbrapsht me

interes. Aq është e vërtetë, që kur Athina u propozoi shteteve të tjera krijimin e një fondi të përbashkët, domethënë të një banke “ndërkombëtare”, cili u emërua president? Apolloni i Delos. Këto perëndi bankiere, për cilindo që depozitonte kapitalin e tij në institutet e tyre, i jepnin si fitim dy ose tre për qind. Por kur vinte dikush që të kërkonte borxh, i kërkonin deri në njëzet për qind interes. Themistokliu, që në luftërat persiane kishte fituar jo vetëm spaletat e gjeneralisimit, por edhe diçka prej rreth tridhjetë milionë drakmash, që nuk dinte se ku t’i çonte, ishte i pari, me sa duket, që iu drejtua një privati në Korinth, te njëfarë Filostefani, i cili i garantoj një fitim prej pesë për qind. Në Athinë, porsa u bë e ditur, nuk u alarmuan aq shumë nga fakti që një gjeneral kishte grumbulluar një pasuri kaq të madhe, sesa për atë që kapitalet po dilnin jashtë. Dhe morën vendim të autorizonin ca shkëmbyes valute, që nga emri tavolinë (trapezi) ku rrinin u quajtën trapezitë, e që dalëngadalë u transformuan në bankierë të vërtetë. Midis tyre u bënë të famshëm Arkestrati dhe Antisteni, që ishin Rrokefeleri dhe Rothshildi i Athinës. Kështu shpërtheu “boom”-i tregtar, i garantuar nga supremacia detare, nga stabiliteti i monedhës dhe nga sistemi huadhënës. Athina nuk eksportonte më vetëm prodhimet e artizanatit të vet që të paguante prodhimet ushqimore. Anijet e saj kryesonin tregtinë dhe mallrat në të gjithë Mesdheun dhe bankierët e saj furnizonin drakme të argjendta për çdo lloj marrëveshjeje dhe kompromisi. Në Pire përdorëshin me qira të gjitha anijet tregtare, ngarkohej e shkarkohej çdolloj malli dhe udhëtarësh dhe bëheshin ndalesa kudo, njëlloj si me urbanet e qyteteve tona. Ja përse në Athinë çdo gjë që ndodhte nuk bënte përshtypje dhe çdo person ndihej “si i shtëpisë”. “Mund të gjesh”, thoshte Isokrati, “atë çka është e pamundur ta gjesh në çdo vend tjetër të botës”. Llogaritej që me një taksë prej pesë për qind mbi qiratë e anijeve, shteti siguronte, vetëm gjatë një

viti, miliona drakme. Por efektet nuk ishin vetëm ekonomike, por dhe morale e shpirtërore. Sepse ishte kjo thirrja e tregtisë së madhe ndërkombëtare që e bëri Athinën qytetin më kozmopolit jo vetëm të Greqisë, por të gjithë botës antike. Kurse ajo vetë i ishte borxhlie në pasuri asaj qoshes së varfër të botës në të cilën Tezeu dhe themeluesit e tjerë kishin rregulluar dhe sistemuar popullin e vogël të Atikës.

Lufta sociale

Gjëja më pak e zakonshme ishte që në këtë Athinë tregtare dhe trafikante të paligjshme, që gumëzhinte nga zhurma e kovaçanave dhe çekiçeve, që adhuronte paranë deri në pikën sa të instalonte bankat nëpër tempujt dhe perënditë t'i bënte presidentë. Qytetarët e përçmonin punën dhe e konsideronin një vdekje të ngadalshme të dinjitetit njerëzor. Pak ndryshim ka kjo dhe pothuaj është njëlloj si edhe në ditët e sotme. Ndërkohë nuk mund të rri pa thënë, se nga sa pashë në gati tri dekada në botë, janë të rrallë popujt që mund të krahasohen për punë me shqiptarët. Është gjë e madhe kjo! Por, për fat të keq, edhe ne kemi të liga të tjera, për të cilat nuk është vendi këtu për t'u ndalur.

Sado kontradiktore dhe jashtë çdo parashikimi që të jenë statistikat e kohës, nuk ka dyshim që këta qytetarë përbënin një minoritet në masën e gjerë të popullsisë. Sipas një analisti të kohës (Dimitrios Falireos, 345 p.e.r.-282 p.e.r., politikan, filozof, orator i Greqisë së Lashtë, statuja e të cilit gjendet sot në hyrje të Bibliotekës së madhe të Aleksandrisë së Egjiptit), nuk i kalonin të njëzetepesë mijtët në një popullsi prej pesëqind mijë banorësh. Nuk e dimë sesi i kishte bërë hesapet. Se në të vërtetë, trashë-trashë e në mënyrë të përafërt ishin më të pakët ata, që duke e

konsideruar dembellëkun si aktivitetin më fisnik dhe kushtin e parë për çfarëdolloj përparimi shpirtëror dhe kulturor, e braktisnin punën dhe e linin si monopol për tri kategoritë e tjera të popullsisë - për metekët, të çliruarit dhe për sklleverit.

Për metekët (fjalë për fjalë do të thotë “bashkëpjesëmarrës”), që në Tiranë i thonë “me ortaklik”, dhe athinasit kishin parasysh atë që anglezët nënkuptojnë me fjalën “aliens”, domethënë të gjithë ata, që ndonëse nuk e kishin pasur fatin të kishin lindur në Athinë, ishin sistemuar me banim aty, por edhe pse të lirë, nuk i gëzonin të drejtat politike.

Ata formonin një klasë të mesme tipike zejtarësh, tregtarësh, sekserësh, magjistratësh dhe zanatçinjsh me prejardhje nga Lindja e Mesme. Ligji i Athinës i trajtonte me përçmim, i përjashtonte ata nga kontratat e minierave, punë shumë e pëlqyeshme kjo dhe fitimprurëse për të mos e lënë atë monopol në duart e të huajve. I pengonte të blinin toka dhe të martoheshin me qytetarë, u impononin shërbimin ushtarak dhe taksat. Por në fushën tregtare, duke pasur nevojë për kontributin e tyre të çmuar, i mbronin duke iu njohur ligjërisht profesionet dhe vlefshmërinë e kontratave.

Pak a shumë në të njëjtat kondita gjendeshin të çliruarit, domethënë sklleverit dhe bijtë e sklleverve që arrinin të fitonin lirinë. Rrugët për të arritur në këtë finish të ëndërruar ishin të ndryshme. Dikujt ia jepte vetë padroni si shpërblim për sjelljen e tij të mirë, dikujt tjetër ia siguronin të afërmit ose miqtë mbas tingëllimit të monedhave të argjendta që kishin mundur të grumbullonin (dhe ishte rasti këtu, ndërmjet të tjerëve, edhe ai i Platonit). Shumë prej tyre e merrnin nga shteti, që ua jepte për t'i grumbulluar dhe për t'i veshur ushtarë atëherë kur listat e rekrutëve të rinj ishin të pamjaftueshme. Por kishte edhe nga ata që e blinin me kursimet e veta, ovollo mbas ovollo për shumë vite me radhë.

Metekët dhe të çliruarit, pavarësisht mënyrës diskriminuese së cilës i nënshtroheshin, e donin Athinën, e konsideronin atdheun e tyre dhe ndiheshin krenarë për këtë.

Madje ishin ata që krijuan “çimenton” lidhëse dhe forcën e saj. Nga radhët e tyre dolën mjekët e mëdhenj, inxhinierët e mëdhenj, filozofët e mëdhenj, dramaturgët e mëdhenj, edhe ata më të vegjlit. Athinasit, besnikë në bindjet e dembellëkut, që kërkonin një administrator të mirë, një kryemjeshër të mirë, një mjek të mirë për familjen etj., e gjenin gjithmonë midis tyre. Dhe në fund të fundit deri në njëfarë pike të gjitha financat e Athinës kontrolloheshin nga dy prej tyre, nga Pacionosi dhe Formionosi që, mbasi ishin punësuar dhe kishin zhvilluar bankat e Arkestratit dhe të Atistenit, u bënë padronët e një qyteti që nuk u jepte nënshtetësinë.

Të vetmit të mjeruarit e vërtetë ishin skllavërit, që ndonëse nuk e kapnin shifrën katërqind mijë siç thotë Falireos-i, por të njëqindmijtët i kalonin me siguri. Ishin pothuaj të gjithë plaçkë lufte ose mbeturina të burgjeve. Nëpër fshatra ishin të pakët, sepse një fshatar vështirë mund të siguronte qoftë edhe një të vetëm me ato farë çmimesh. Në tregun e Delos, që ishte më i rëndësishmi dhe ku ekspozoheshin lakuriq, një skllav në gjendje të mirë kushtonte deri në një gjysmë milioni. Pastaj, në ndryshim me atë çka bëhej në Romë, ku padroni kishte të drejtë edhe ta vriste, skllavi në Athinë i gëzonte disa të drejta nga ligji. Po ta vrisje, përfundojë menjëherë në gjyq i akuzuar për vrasje. Dhe po ta rrihe shumë, mund të largohej dhe të kërkonte strehim në një tempull, prej nga nuk mund ta nxirrje më dhe të detyroheshe që ta shisje me një çmim, siç i thonë fjalës, për një copë bukë.

Me përjashtim atyre që përfundonin në miniera, ku punonin dhjetë orë në ditë dhe shpejt a vonë mund të vdisnin të mbuluar nga një shembje dheu, fati i të tjerëve nuk ishte edhe aq i zi.

Shumë prej tyre i merrte shteti si personel shërbimi, portierë, roje, fatorino, me rroga të ulëta dhe me liri qarkullimi dhe banimi. Të tjerë futeshin nëpër familje si karrocierë, kuzhinierë, kamerierë por edhe si shkrues dhe bibliotekarë, të cilët përfundonin si pjesëtarë të barabartë të familjeve. Si përfundim duhet thënë se qytetërimi i lartë i Athinës e praktikoi skllavërinë krejt ndryshe dhe në një mënyrë shumë më njerëzore nga sa e praktikoi Roma e lashtë. Vetëm që nuk e bëri atë një problem të ndërgjegjes edhe pse ndonjë filozof e zuri me gojë. Sokrati nuk e përmendi fare. Kurse Platoni tha që ishte një gjë e shëmtuar që disa grekë mbanin për skllavër grekë të tjerë. E besoj këtë! sepse i kishte takuar atij vetë që ta provonte. Për të huajt, nënkuptonte se ishte e logjikshme që t'i mbanin si shërbëtorë. Për sa i përket Aristotelit, ai përkrahte një teori gjerësisht “marksiste” duke shkruar se skllavëria nuk ishte as morale e as imorale, por vetëm një nevojë e imponuar nga një shoqëri “kapitaliste” që nuk e kishte bërë akoma revolucionin e saj industrial. “Do të jenë makinat, dhe jo ligjet, ato që do t'i çlirojnë skllavërit duke i bërë ata të panevojshëm”, vazhdonte më tej ai.

Por moralisht ishin poshtë. Sepse Odiseu, që paraqitej si model dhe shembull, ishte një nga gënjeshtarët më të pafytyrë dhe ngatërrestarët e historisë së njerëzimit. Njësia matëse e madhështisë së tij ushqeje vetëm nga suksesi, pa gjykuar fare për mjetet që përdorte, me të cilat arrinte fitoret.

Që regjimi i Athinës, kur Perikliu erdhi në fuqi, ishte kapitalist, për këtë nuk ka asnjë dyshim. Prona mbi tokën, që në kohët e lashta ishte e “popullit”, tani ishte private. Bankat, shoqëritë e mëdha të lundrimit, industrisë, ishin private. Shtetit i mbetej vetëm nëntoka, por edhe atë nuk e administronte vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Por duhet të shtojmë që problemi social mbetej i kufizuar në pakicën e qytetarëve. As politikanëve më radikalë nuk u shkonte në mendje që të bënin pjesëtarë metekët dhe të çliuarit.

Disnivelet ekonomike, midis qytetarëve, nuk ishin shumë të mëdha. Me përjashtim të Themistokliut (527-459 p.e.r., që ishte politikan dhe strateg gjeneral që krijoi fuqinë detare të Athinës, kryesonte krahun demokratik të shoqërisë) rasti i të cilit në fakt konsiderohej skandaloz, dhe iu desh që të largohej për të shpëtuar kokën dhe pasurinë, nuk kishte miliarderë të tjerë. Pasuritë e mëdha për të cilat flitej me një përzierje lakmie dhe admirimi, ishin ato të Kalias dhe të Nikeas. Në origjinën e luftës së klasave të Athinës, kishte më shumë një konflikt idesh dhe morali sesa interesash. Le të marrim për shembull Alqiviadhin (gr. Ἀλκιβιάδης, lat. Alcibiades – politikan, orator dhe gjeneral i athinasve i nivelit shumë të lartë, Athinë rreth 450-404 p.e.r.), një nga figurat më të shquara të luftës, që do të bëhej edhe një nga protagonistët e luftës së Peloponezit. Bënte pjesë në aristokracinë e tokave, në mes të së cilës konsiderohej ndër më të pasurit sepse posedonte njëzet hektarë, që në një Atikë të copëzuar në shumë prona të vogla konsiderohej një latifondist. I ardhur nga një kasolle fshati, që ai e quante me pompozitet “kështjellë”, por që nuk ishte gjë tjetër veç se një shtëpi fshati me stallën dhe qilarin e barit dhe të veglave, me të cilat i ati lëronte tokën me qetë, kur erdhi në qytet i shikonte moshatarët e tij borgjezë, vilat e tyre komode dhe veshjet e modës, si një mungesë të theksuar kujdesi ndaj tij. Ai ndiente një përçmim të madh për këta pasanikë të rinj, që në fakt e meritonin, por dhe për demokracinë e tyre, dhe përpiquej të dallohej nga ata duke shtuar në kartën e vizitës, pranë emrit të tij edhe emrin e të atit, ashtu siç bëjnë sot disa të huaj të shteteve latine që para mbiemrit, shtojnë edhe një “de”. Me pak fjalë, edhe ky baron i vogël tokash, ëndërronte të pasurohej, nën nxitjet e gruas së cilës i pëlqenin peliçet e shtrenjta dhe pallati më i bukur i qytetit, por që në pazar nuk vlente asnjë grosh, dhe në shtëpi gumëzhinte si mizë kali.

Tani, në dispozicion të këtyre fisnikëve të varfër demokracia nuk linte asnjë mundësi tjetër përveçse një të vetme, të bënin kryengritje politike, domethënë bashkë me qytetarët e klasave më të varfra. Teorikisht këta duhej të ishin fshatarët, që varfëria e tokës dhe dimensionet e pronës i kishte dënuar të gjithë në një epidemi mjerimi. Por ata ishin pak të ndjeshëm ndaj ideve revolucionare. Dhe pastaj, edhe po të ishin anëtarë të Asamblesë, me të drejtë do të vinin rrallë atje për mungesë të mjeteve të komunikacionit. Ishte pikërisht kjo gjë që e kufizonte me rreptësi demokracinë e Athinës. Me një popullsi prej afro pesëqind mijë banorë, protagonistët e saj ishin rreth tridhjetë ose dyzet mijë qytetarë. Por edhe prej tyre, ata të fushave përreth, që në numër ishin sa gjysma e mirë, ishin përjashtuar për shkak të vështirësive reale të udhëtimit. Gjithçka pra zhvillohej ndërmjet pesëmbëdhjetë ose njëzet mijë personash që jetonin brenda rrethit të mureve të qytetit, që njiheshin midis tyre, takoheshin çdo ditë dhe thërrisnin njëri-tjetrin me emër. Ja përse eksperimenti demokratik i Athinës arriti të kapë në histori një vlerë kaq të veçantë dhe u dallua për qartësi e realizëm të theksuar.

Pasardhësit e aristokracisë së varfëruar kërkonin përkrahës në mes të të pakënaqurve të një demokracie kapitaliste, që favorizonte vetëm klasat e larta dhe të mesmet. Nuk ishte e vështirë të kuptohej se cilët ishin ata. Të gjithë ata që, në një regjim të konkurrencës së lirë, mbeteshin mbrapa të tjerëve. Dhe të tillë kishte plot: mjaftonte të shihje pagat dhe rrogat. Është e vështirë që sot të llogaritësh fuqinë blerëse të drakmës. Por nga përlllogaritjet që bëjnë kompetentët më të besuar, për një familje prej katër personash nevojiteshin nja njëqind të tilla në muaj për të jetuar siç jetohet sot me rreth treqind mijë lekë të vjetra. Por, fitimet e një artizani dhe paga e një nëpunësi të vogël nuk i kalonte të tridhjetë drakmat.

Prej këtej, rrjedhin pretendimet, kërkesat dhe “instancat shoqërore” mbi të cilat aristokracia në rënie kërkonte mbështetje. Ajo nuk e interpretonte ardhjen e saj në pushtet, siç bënte deri vonë socializmi te ne, duke reklamuar shtetëzimet që kishte bërë fill mbas çlirimit. E interpretonte duke reklamuar se po të vinte në fuqi, do të shuanin borxhet, se do të bëhej shpërndarje e grurit falas, dhe do të ishin të gjithë pjesëtarë në fitimet e industrisë dhe të tregtisë. Kuptohet kjo, pa përjashtim për të gjithë qytetarët. Edhe për metekët edhe për të çliruarit, për të mos folur për skllëvërit sepse për ta nuk interesohej askush. Aristofani vuri në skenë atëherë komedinë “Gratë në Parlament” me një tip “konteshe të së majtës” që predikonte pikërisht një lloj komunizmi aristokratik që reklamonte shpërndarjen e të mirave materiale në pjesë të barabarta në mes qytetarëve, dhe të gjithë përfitimeve të punës kolektive. “Po punën kush do ta bëjë?!” , e pyeste Blepiri, personazhi kryesor. “Po, skllëvërit, kuptohet”, përgjigjej dama.

Këto ishin konkluzionet, dhe elementet e debatit popullor mbi luftën e klasave në Athinën e Lashtë, me një parti “socialiste” që pak a shumë korrespondonte me atë, që deri dje te ne ishte partia e punës. E gjitha e përbërë nga klasa të interesuara rreth progresit, por e përmbajtur e me shumë kufizime, e rrezikuar dhe kërcënuar, nga një e djathtë ekstreme dhe një e majtë totalitare, të lidhura këto siç qëllon shpesh, në aleancën e fesë së shenjtë të reaksionit.

Kësisoj le të mos ekzagjerojmë. Edhe pse aktive dhe plot polemika idesh në Parlament, në mbledhjet dhe nëpër sallonet, kjo luftë klasash ishte gjithmonë e zbutur nga frika se mos i bashkonte dhe i barazonte të tridhjetë apo dyzet mijë qytetarët, nga frika se mos gjendeshin të shtypur nga të treqind-katërqind mijë metekët, nga të çliruarit dhe nga skllëvërit, mbi masën e të cilëve minoriteti i tyre i brishtë synonte të qëndronte gjithmonë përmbi të tjerët.

Pavarësisht nga kjo, ishin këta “marksistë” të Athinës, me emblemat dhe stemat në kartëvizitat e tyre, që shpikën flamurin nën të cilin, që atëherë e deri më sot, militojnë dhe luftojnë të gjithë komunistët e të gjithë kohërave në botë; flamurin e kuq. Kështu pra që ai, nuk ka asnjë origjinë proletare siç akoma besohet deri më sot, por origjinë aristokratike.

Jeta kulturore, teatri

Teatri lindi në Greqi gjysmë i shenjtë dhe gjysmë pornografik. Dhe ishte e natyrshme, duke parë origjinën e tij, që të kishte ndërthurje fetare, sepse pothuaj gjithmonë subjekti i tij ishte me argument mitologjik. Teatri i parë që u ndërtua, i dedikuar natyrisht perëndisë Dionisit, u ndërtua mbi një shkëmb të Akropolit. Arkitektët që e ndërtuan i dhanë sensin panoramik gjysmë rrethor, që nxinte një mijë e pesëqind spektatorë. Si tavan, natyrisht ishte qielli, që në Athinë është i bukur dhe i pastër. Vendet nuk kishin mbështetëse, me përjashtim të atyre që ishin rezervuar për shërbështarët e Dionisit. Skena ishte e tëra prej druri dhe e çmontueshme në mënyrë që të kishte mundësi për adaptime të ndryshme. Grekët nuk kishin kërkesa të veçanta për regjinë dhe mobilimin. Vetëm më vonë Euripidi shpiku një lloj vinçi, apo vetëm e perfeksionoi atë, që kur subjekti dukej se kishte ngecur në një pikë të vdekur, perëndia ose heroji, që gjithmonë ishte protagonist, zbriste nga qielli dhe e zgjidhte problemin me fuqinë e një mrekullie.

Por shfaqja e vërtetë në teatër, ishte publiku, që ishte shumë i ngjashëm me atë të teatrit japonez të Kabuki-t (që mbështetet në tri ideograme me kuptimet: ka – këngë, bu – valle, dhe ki – zotësi). Hyrja ishte me pagesë. Por për atë që nuk kishte dy

ovolo për të paguar biletën, e merrte atë falas nga shteti. Prandaj vinin aty familje të tëra, me dinasti dhe në tufa. Në hyrje sekset ndaheshin, dhe oborrtarët kishin një të ndarë të veçantë. Shfaqja vazhdonte një ditë të tërë, nga agimi deri në mbrëmje. Në skenë vinin njëra mbas tjetrës pesë vepra: zakonisht tri tragjedi, një komedi satirike dhe një monolog. Prandaj ky organizim duhej të përballohej si një olimpiadë e tërë me furnizime me ushqime, me pije, jastëkë, zare për lojëra të ndryshme dhe fjalë kryqe si dhe kapela të çdo lloji për t'u mbrojtur nga dielli. Ishte si të thuash një “plate” e paqëndrueshme, ku hahej, pihej, shkëmbenin vendet për të bërë vizita te njëri-tjetri, dhe ku manifestohej lirisht gjithçka që mendohej. Shpërthenin duartrokitje, dëgjoheshin vibracionet e përqeshjes me llapë e me buzë, dhe fluturonin në ajër fiq e domate dhe nganjëherë edhe gurë. Një herë një muzikant u mburr se e kishte ndërtuar shtëpinë me gurët dhe tullat që i kishin hedhur mbi vete. Aktorët e personazheve negative apo ato të papëlqyeshme, shumë herë rrezikonin kokën, kurse personazhet pozitive dhe simpatike brohoriteshin me thirrjet: “Janë tonët!”. Dhe për autorët jepeshin edhe çmime. Për tri tragjedi çmimi i parë që jepej ishte një dhi, për një komedi një shportë me fiq. Çmimet vendoseshin nga dhjetë gjykatës të zgjedhur nga spektatorët. Secili prej tyre, në përfundim, shkruante mendimin e tij mbi një tabelë të vogël. Më pas ato mblidheshin në një vorbë të përbashkët, kurse kryetari kapte rastësisht pesë prej tyre dhe lexonte vendimet. Kështu nuk dilte kurrë se cilët ishin ata të pestët, ndërmjet të dhjetëve, që kishin dhënë çmimet. Dhe kishin besim athinasit te njëri-tjetri! Aq sa kanë edhe shqiptarët sot. Platoni shkroi më vonë, se kjo mënyrë “teatrokratike” dhe shpërndarëse zarfesh korruptive që kishte shpërblyer me një dhi “Orestiadhën” e Eskilit dhe me një kaçile fiq komedinë “Retë” të Aristofanit, i dukej një skandal i vërtetë.

Eskili çmimin e parë nuk e fitoi si dramaturg në skenë, por si luftëtar në betejë kundër Darit, mbretit të persianëve, kur ai trokiti në portat e Athinës. Qeveria mbas kësaj, urdhëroi një piktor të paraqiste një kuadër, me skenat e heroizmit të tij. Askush më mirë se ai, që kishte marrë pjesë në luftë, nuk mund t'i paraqiste në teatër ato mbresa.

Për atë kuadër ishin kandidatë dy rivalë. Njëri ishte Parrasi i Efesit dhe tjetri një personazh krejt i panjohur, që u shfaq papritur një ditë si piktor. Nuk dihet se prej nga erdhi. Në kurorën që mbante mbi kokë, kishte shkruar emrin me fije të trasha ari, “Zeusi i Eraklias”. Nuk kemi asnjë element që të gjykojmë nëse kuadrot e tij ishin në lartësinë e mendimit që ai kishte për vetveten. Por kemi bindjen se që prej asaj kohe, mënyra më e mirë për të fituar rëndësi dhe sukses, ishte të shisje sa më shumë dëngla. Prandaj ai nuk i dha konfidencë asnjërit. Shihte, fliste dhe pikturonte duke i parë të tjerët nga lart, sikur të ishin vartësit e tij. Të njëjtën gjë bëri edhe me Parrasin e Efesit, i cili nga ana e tij ishte vetëshpallur si “princi i piktorëve”.

Por që të dy, mundoheshin ta injoronin dhe të vinin në lojë njëri -tjetrin në sytë e opinionit publik. Më së fundi të dy rivalët pranuan të përballeshin përpara një komisioni, që do të vendoste se cili prej tyre ishte më i zoti dhe do të bënte veprën. Zeusi paraqiti një natyrë të qetë, në të cilën kishte pikturuar një pjergull me disa bistakë rrushu shumë të pjekur. Ishin kaq të vërteta, saqë siç thonë një tufë zogjsh u lëshua mbi të për t'i çukitur kokrrat. Gjykatësit lëshuan britma entuziazmi, dhe autori i sigurt për fitoren, e ftoi Parrasin që ta ngrinte atë vellon e hollë me të cilën kishte mbuluar kuadrin, në mënyrë që të gjithë të shihnin më mirë pikturën e tij.

Por edhe velloja ishte e pikturuar, dhe Zeusi me shumë kavalieri e mirësjellje pranoi humbjen dhe mbas kësaj e la Athinën. Kështu, kuadrin e bëri Parrasi.

Më 484 p.e.r., Eskili fitoi çmimin e parë. Por katër vjet më vonë persianët u kthyen përsëri, këtë herë me Kserksin, për të marrë revanshin. Eskili, tashmë dyzetepesëvjeçar, hodhi tej përsëri penën, rroku shpatën dhe luftoi me entuziazmin e një njëzetvjeçari në Salaminë, në Artemisë dhe në Platea. Më 479 p.e.r. vazhdoi përsëri punën e tij si dramaturg dhe rregullisht, vit për vit, fitoi çmimin e parë deri më 468 p.e.r., vit ky që iu desh t'ia linte këtë çmim dikujt tjetër, një të riu njëzetegjashtëvjeçar krejt të panjohur, njëfarë Sofokliu. E fitoi përsëri vitin tjetër. Por vazhdoi humbjet në vitet që pasuan, deri më 458 p.e.r., kur triumfoi me “Orestiadën”.

Megjithatë e kuptoi se tashmë ishte shfuqizuar nga Sofokliu, dhe ndoshta pikërisht për këtë arsye mori udhën e u largua nga Greqia. Emigroi në Sicili, ku kishte qenë edhe herë të tjera dhe ku Geroni që qeveriste e priti me nderime të mëdha. Atje vdiq në moshën shtatëdhjetë e dy vjeç, siç tregonin njerëzit, për shkak të një shqiponje e cila kishte rrëmbyer një breshkë dhe në ajër i shpëtoi nga thonjtë apo e lëshoi vetë që në rrokullimë nga lart i ra poetit sipër kokës tullace duke e lënë të vdekur pikë përdhe. Athina deshi të shohë e të dëgjojë tragjeditë që kishte shkruar në Sicili dhe i dha përsëri çmimin e parë, edhe pse i vdekur.

Eskilit i detyrohet një reformë e rëndësishme në teatër, që vazhdoi në brezat pasardhës. Tema që ai zgjodhi ishte lufta e njeriut kundër fatit, domethënë e individit kundër shoqërisë, e mendimit të lirë kundër traditës. Eskili nga shtatëdhjetë apo siç thonë nëntëdhjetë tragjeditë e tij përcaktoi rregullisht fitues fatin, shoqërinë dhe traditën, sepse vetë jeta dhe vepra e tij na jep shembullin e një nënshtrimi ndaj këtyre vlerave. Por në shtatë veprat që na kanë mbërritur prej tij, dhe përmbi të gjitha te “Prometheu”, bie në sy simpatia e autorit për rebelin e munduar e të vuajtur. Me sa duket publiku nuk e priti mirë dhe i fishkëlleu

gjykatësit që i dhanë çmimin e madh. Por Eskili e dinte mirë çfarë dialogësh kishte vënë në gojën e protagonistëve të tij. Dhe më shumë se dy mijë e dyqind vjet më vonë, filozofi, kritiku dhe themeluesi i romanticizmit gjerman Karl W. F. von Schlegel, që në shumë gjëra i ngjante, tha që “Prometheu” nuk ishte një tragjedi, por ishte “tragjedia”.

Ai që i zuri vendin Eskilit ishte i biri i i një armëpunuesi, i cili në dy gjëra goditi në shenjë: në profesionin e tij dhe në emrin që i dha të birit. Luftërat e gjata me persianët varfëruan pothuaj të gjithë bashkëqytetarët e Athinës, por si armëpunues e pasuruan atë vetë dhe i dhanë mundësi t’i linte një pasuri të mirë të birit, të cilit i dha emrin Sofokli, domethënë “i mençur dhe i nderuar”. Kësaj pasurie dhe këtij emri, Sofokliu nga ana e tij i shtoi edhe kusurin: ishte i bukur dhe i shëndetshëm. Një muzikant i shkëlqyer i harpës dhe atlet i përsosur që fitoi shumë popullaritet si kampion, në lojërat dhe garat që zhvilloheshin në Greqi.

Është vendi këtu të themi diçka që nuk është thënë: Ndërmjet garave të shumta që zhvilloheshin në Greqinë e Lashtë, gara e Maratonës nuk ekzistonte. Por luftëtari Filipides, për të sjellë lajmin e fitores kundër persëve, vrapoi 42 kilometra nga Maratona në Athinë dhe frymën e fundit e la në Agora, në mes të pazarit të Athinës. Ishte i vetmi kampion i Botës që nuk mori çmime apo medalje, nuk u ngrit lart dhe nuk iu bë reklamë, dhe as u përjetësua me ndonjë statujë. Për më tepër, emrin e tij nuk e mori asnjë Olimpiadë dhe as ndonjë garë atletike.

Si përfundim përveç teatrit, Sofokliu bëri karrierë të shkëlqyer edhe në politikë. Perikliu e emëroi ministër të Thesarit, dhe më 440 p.e.r. i dha spaletat e gjeneralit në komandën e një brigade në fushatën kundër ishullit të Samos. Por duhet të pranojmë se si strateg nuk dha ndonjë provë të madhe, sepse vetë “autokratori”, perandori, tha më vonë që e preferonte më mirë si dramaturg. I

pëlqenin paratë, administroi me mënjëri ato që i kishte lënë i ati, dhe fitoi shumë nga të tijat. Ishte i devotshëm ndaj perëndive, drejtonte lutje dhe bënte për to sakrifica me përpikëri skrupuloze. Por si kompensim kërkoi prej tyre të drejtën që të tradhtonte gruan dhe të frekuentonte skutat më të dyshimta të Athinës. U “normalizua” vetëm kur u mplak dhe filloi t’u vardisej e t’i lajkantonte gratë. U dashurua me një oborrtare, me Teoridën, e cila i dha një djalë bastard. Ai i ligjshmi, Jofonti, duke pasur frikë se për shkak të vëllait të paligjshëm, i ati do ta linte pa trashëgimi e denoncoi në gjyq me qëllim që ta konsideronin të papërgjegjshëm dhe se tashmë e kishte humbur gjykimin. Por plaku i mençur nuk foli fare kundër të birit. Vetëm u lut që trupi gjykues të dëgjonte një pjesë të shkurtër nga tragjedia “Edipi në Kolono”, që po shkruante atë kohë. Dhe gjykatësit jo vetëm e dëgjuan me admirim, por në fund në shenjë respekti e shoqëruan deri në shtëpi.

Ishte gati nëntëdhjetë vjeç kur vdiq, më 406 p.e.r. Epoka e bukur e Athinës tashmë kishte mbaruar, dhe spartanët kishin rrethuar qytetin përsëri. Në mes të popullit qarkulloi fjala se Dionisi, perëndia i teatrit i qe shfaqur në ëndërr Lizandrit, mbretit të spartanëve që kishin rrethuar Athinën, dhe e kishte shtrënguar që të linte një rrugë kalimi për miqtë e Sofokliut që donin ta çonin trupin e tij në Deselia, për ta varrosur në varrin e familjes. Kuptohet fantazi! Por që duan të tregojnë se çfarë popullariteti gëzonte ky personazh i jashtëzakonshëm.

Kishte shkruar njëqind e trembëdhjetë tragjedi, dhe nuk ishte kufizuar vetëm që t’i vinte në skenë, por kishte recituar edhe vetë në to si aktor derisa iu trash e iu ngjir zëri. Në ndryshim nga Eskili, Sofokliun në veprat e tij e interesonte më shumë njeriu sesa ideja. Dhe pikërisht e përmbi të gjitha, këtu qëndron modernizmi i tij. Ishte një “klasik” në kuptimin e plotë të fjalës. Dramat e tij janë të përsosura nga ana teknikës teatrale. Dhe personazhet që

i frymëzojnë, në vend që të predikojnë, siç bënin tek Eskili, më shumë veprojnë. “Unë i vizatoj ashtu si duhej të ishin”, thoshte ai. “Është Euripidi ai që i vizaton ashtu siç janë.”

Euripidi, ky rival i ri i Sofokliut të madh, kishte lindur në Salaminë, në të njëjtën ditë, siç thonë, që u zhvillua beteja e famshme. Prindërit e tij ishin të një klase të mirë të mesme, edhe pse Arstofani kishte hedhur dyshimin se e ëma, shiste lule nëpër rrugë. Djali u ngjit lart nga pasioni për filozofinë dhe studioi nën Anaksagorën dhe Prodikon. U lidh me një miqësi të ngushtë me Sokratin që më vonë e akuzuan se dramat që kishte shkruar ishin prej tij, gjë që nuk ishte aspak e vërtetë. Sesi u bë shkrimtar i teatrit nuk dihet. Por nga tetëmbëdhjetë vepra që na kanë mbërritur prej tij, nga shtatëdhjetë e pesë që shkroi, del e qartë se për teatrin Euripidi në fakt nuk kujdesej aq shumë, sesa e konsideronte atë një mjet për të shfaqur tezat e tij filozofike. Aristoteli kishte të drejtë kur thoshte se nga pikëpamja e teknikës dramatike, ai paraqiste një hap mbrapa në krahasim me Eskilin dhe Sofokliun. Por personazhet e tij, Elektra, Ifigjenia dhe Medea, janë karakteret më të gjalla të tragjedisë greke. Ishte brenda tij një Bernard Show i proporcioneve gjigante, që luftonte për një rend të ri moral dhe shoqëror. Dhe e udhëhiqte këtë kryqëzatë i ndërgjegjshëm për rreziqet që ajo sillte, sepse Athina e atëhershme nuk ishte Anglia e ditëve të sotme. Shpeshherë ndërpriste në gojën e një personazhi një arsyetim të rrezikshëm, për t'i lejuar korit që të ndërhynte e të ngrinte një himn për Dionisin, të destinuara të gjitha këto, për të siguruar censurën dhe për të qetësuar protestat e mundshme të spektatorëve fanatikë. Por herë mbas here i shpëtonin fraza si “O Zot, i pranueshëm ti qofsh, sepse për ty vetëm me të dëgjuar e kam që thonë se...”, që shkaktonin shtrëngata në platenë e spektatorëve. Dhe kur në dramën “Ipoliti” e vuri heroin e tij të thotë: “Po, gjuha ime e bëri betimin, por shpirti im prapë mbeti i

lirë”, athinasit, që thyerjen e besës e kishin të zakonshme por nuk donin ta dëgjonin, sepse nuk e pranonin, u egërsuan dhe deshën ta linçonin, dhe Euripidit iu desh të paraqitej para publikut për t’i qetësuar e për t’u kërkuar që të kishin durim e të prisnin, sepse për ato fjalë rrënuese për të shenjtin, Ipoliti në fund, do të ndëshkohej shumë rëndë. Por as në fund nuk i shpëtoi shqyerjes.

Është në muzeun e Luvrit një bust i Euripidit, që e tregon me mjekër, të rëndë nga pamja dhe melankolik, që korrespondon me përshkrimin që lanë për të miqtë e tij. Ata e përshkruajnë të heshtur, të pashoqërueshëm dhe lexues i madh i librave për të cilat ishte një koleksionist i madh. Idetë e tij e kishin futur në polemikë me konservatorët, të cilët e urrenin. Aristofani e vuri në shënjestër në tri komeditë e tij satirike.

E, megjithatë, tregues i qytetërimit të madh të Athinës ishte fakti që kur Euripidi dhe Aristofani takoheshin në Agora, silleshin me njëri-tjetrin, si të ishin miqtë më të mirë të kësaj bote. Vetëm në pesë raste guxuan gjykatësit t’i jepnin çmimin e parë. Sa për spektatorët, gjithmonë indinjoheshin, por në shfaqjet e para ama, nuk gjendej vend edhe sikur ta paguaje me flori.

Në vitin 410 p.e.r. i hapën një proces gjyqësor dhe e akuzuan për mungesë të rëndë të respektit fetar dhe për imoralitet. Ndërmjet dëshmitarëve të akuzës ishte edhe gruaja e tij, që nuk ia falte indiferencën që tregoi në momentet kur Athina ishte në luftë për jetë a vdekje me Spartën. Ndërmjet dokumenteve të akuzës u paraqit edhe monologu i tij tek “Ipoliti”, i cili nuk qe harruar. U mbrojt me zgjuarsi, dhe i akuzuari u la i lirë. Por mënyra sesi publiku priti dramën e tij të re “Gratë trojane”, i dha të kuptojë se tashmë ishte një i huaj në atdheun e vet. Me ftesën e mbretit Arkelao, u transferua në Pela, kryeqytet i Maqedonisë. Dhe atje vdiq, siç treguan grekët, i shqyer nga qentë, hakmarrës për fyerjet ndaj perëndive.

Sokrati kishte thënë se për një dramë të Euripidit, nuk e kishte të rëndë të shkante me këmbë deri në Pire, çka donte të thoshte se për një të munduar të kategorisë së tij, përbënte një sakrificë të madhe. Dhe Plutarku shkruan se kur sirakuzasit kapën robër shumë nga trupat që kishte dërguar Athina, u falën jetën dhe u rikthyen lirinë ushtarëve që dinin të recitonin ndonjë skenë të Euripidit. Sigurisht që ai që dramaturgu i parë në botë “me mendim”, që vuri përballë, në termat e tragjedisë kjo, konfliktin e madh të të gjitha kohërave: konfliktin ndërmjet parimeve të një doktrine që nuk mund të vihej në diskutim dhe ato të mendimit të lirë njerëzor.

Po të lexosh tragjeditë greke, mund të kuptosh më mirë se pse publiku, mbasi kishte dëgjuar tri prej tyre në një ditë, madje në rresht njërën mbas tjetrës, ndiente nevojën, para se të shkante në shtrat, të dëgjonte një komedi. Kjo sepse tragjeditë nuk e linin për asnjë çast në paqe spektatorin, por e mbanin në tension nga skena e parë deri tek ajo e fundit.

Dhe komediografët grekë, me Aristofanin përfaqësues kryesor, e përdorën komedinë, njëlloj siç përdoret sot shtypi dhe gazetaria, për të sulmuar dhe tallur qeveritë, partitë, njerëzit dhe idetë. Por në të vërtetë, në shënjestër ata kishin pikërisht demokracinë dhe kryetarin e saj të madh, të cilit ia dedikonin ekzistencën e tyre, Perikliun. Ishte mënyra e vetme që të bënin opozitë politike, dhe ajo, nga ana e saj, ishte një mënyrë për të ushtruar të drejtën demokratike.

Por në ndryshim nga të tjerët, Aristofani, me të drejtë mund të quhej një reaksionar i vërtetë. Vinte nga një familje fisnike, por provinciale, dhe vetë jeta e tij e vërteton këtë. Kishte një simpati të sinqertë për Spartën, madje edhe kur lufta kishte shpërthyer midis asaj dhe Athinës. Ndoshta po të kishte lindur në një regjim tjetër, do të ishte bërë një poet i natyrës, siç e tregojnë vargjet

fragmentare që na kanë arritur prej tij deri më sot, me një frymëzim të lartë dhe të një stili perfekt. Por erdhi në këtë botë në 450 p.e.r., dhe jetoi që në moshë të re në një demokraci që nuk ishte më ajo njerëzorja e Perikliut, por trashanikja e lëkurëpunuesit e Kleonit. Aristofani me idetë e tij të opozitës ndaj regjimit, e vuri shumë shpejt Kleonin, “në grykën e pushkës”, në komeditë e tij. Por në një mënyrë të tillë sa që askush nuk guxonte t’i luante ato pjesë. Prandaj autori vetë doli që në fillim në skenë i veshur si strategu, i cili, nga ana e tij, asistonte në plate dhe krejt i heshtur dëgjonte talljet e pamëshirshme që i bënte. E duartrokiti në fund, pastaj të nesërmen në mëngjes, e denoncoi Aristofanin dhe i vuri një gjobë të rëndë sa që mezi i mbloodhi paratë për ta paguar.

Nga kjo gjë na lind një dyshim, se ndoshta kokëtrashë Kleoni, nuk ishte dhe aq kokëtrashë sa ç’është folur. Mbasi pagoi gjobën, komediani shkroi një komedi tjetër, që edhe atë e luajti vetë në skenë. Aty e bënte akoma më rezil sesa herën e parë. Publiku shpërtheu në të qeshura dhe brohoritje. Por këtë herë, në mes atyre që brohoritnin më shumë, ishte edhe Kleoni. Demokracia e Athinës ishte në duar të tilla që dinin ta bënë. Dhe askush nuk e demonstroi më mirë se ai, Aristofani, që kishte marrë përsipër ta diskreditonte.

Një tjetër objektiv që Aristofani vuri në sy, ishte miku i tij Sokrati, i cili e pa veten të tallur në një mënyrë të pashpirt. Kjo sepse përveç kusureve të tjera, ai kishte probleme edhe me Ksanthipin, me gruan e tij. Ajo thoshte që Sokrati nuk kujdesej fare për veten e tij, pa lëre për të tjerët. Vishej gjithmonë, dimër dhe verë, me të njëjtin qyrk të ndotur dhe të arnuar. Pinte shpeshherë dhe me qejf, dhe siç thoshte Ksathipi, nuk lahej. Aristofani e vuri në komedinë “Retë” dhe veçanërisht e talli aq keq, sa që edhe aktori që e luajti nuk pati nevojë fare që ta bënte karikaturë, sepse

në fakt në pamje Sokrati ishte vetvetiu një karikaturë. E kishte keqtrajtuar të mjerin, në rolin e “Bakallit të mendimit” deri në atë pikë, saqë ishte për të ardhur keq. Sokrati nuk ishte fare i bukur, të paktën në kuptimin grek të fjalës. Kishte një hundë të gjerë si të sqapit, buzë të trasha, një ballë të rëndë dhe nofullën të gjerë si të fshatarëve. Alqiviadhi i pafytyrë edhe pse ishte nxënës i tij, i thoshte me të qeshur: “Nuk mund ta mohosh i dashur Sokrat, që fytyra jote ngjan me atë të një satiri”. Por mjeshtri nuk ia merrte për keq dhe përgjigjej: “Ke shumë të drejtë, dhe për më tepër kam edhe plëncin, prandaj duhet të më detyroni të hedh valle që të reduktoj proporcionet”. Ky Alqiviadhi, ishte një personazh i jashtëzakonshëm dhe turbullues: dhunues i ligjeve dhe i grave, mashtrues dhe trulllosës jo vetëm i zemrave femërore, por edhe i masave elektorale. Ishte një përçmues i paqes dhe një luftënxitës, sepse lufta për të paraqiste një rrugë më të shkurtër për ambiciet e veta.

Ndërsa kjo Ksanthipi kaloi më pas te pasardhësit si personifikimi i gruas grindavece, llafazane, dhe mbytëse. Dhe ishte e natyrshme që të ishte kështu sepse biografinë e Sokratit, madje biografitë e tij, i shkruan miqtë dhe nxënësit e tij, të cilët ia urrenin të shoqen. Secili prej tyre shkroi dhe e përshkroi mësuesin me mënyrën e vet. Diogjeni na thotë, se kur lexoi një herë profilin që Platoni kishte shkruar për të, Sokrati thirri: “Për Zotin!, sa gënjeshtër paska shkruar ky djalë për mua!”. Por edhe Ksanthipi i urrente nxënësit e tij, sepse i merrnin burrin nga shtëpia. Në fakt Sokrati nuk kishte shumë kujdes për familjen. Në shtëpi nuk jepte asnjë grosh, sepse nuk fitonte asnjë, dhe mungonte për ditë dhe net të tëra. Gruaja arriti deri në atë pikë, saqë e denoncoi në gjyq për shmangie nga detyrat familjare. Sokrati në vend që aty të mbronte veten, mbronte gruan. Dhe jo vetëm përpara gjykatësve, por edhe përpara nxënësve të indinjuar. Thoshte që, si grua, kishte

plotësisht të drejtë, se ishte një grua e zonja dhe se meritonte një burrë më të mirë se ai. Por mbasi e liruan, vazhdoi përsëri i qetë zakonet e tij jashtë shtëpiake dhe jo gjithmonë të pafajshme. Sepse nuk shkonte vetëm me Aspasinë, por edhe me Teodatën, që ishte prostituta më me famë e Athinës. Por të gjithë e donin shumë, sepse ishte gjithmonë i qeshur dhe nuk ofendohej kurrë nga asgjë dhe gjërat më të ngatërruara, i thoshte me fjalët më të thjeshta. Dyqanxhinjtë dhe tregtarët e përshëndetnin me ngrohtësi kur kalonte rrugës i ndjekur nga nxënësit e tij. Ishte babai themelues i vërtetë i filozofisë. Nga shkolla e tij, “nga qilari”, doli në sipërfaqe çdo gjë: një idealist si Platoni, një mendimtar si Aristoteli, një skeptik si Euklidi, një filozof epikurian, me shkronjë të madhe, si Aristipi, një aventurier politik si Alqiviadhi, dhe së fundi një gjeneral dhe profesor i historisë si Ksenofonda. Ishte e natyrshme që nga një laborator aq i gjerë, të ishin prodhuar edhe shumë lloj helmesh kundër regjimit demokratik. Prandaj në momentin e vdekjes, (për të cilën, një pjesë e madhe e fajit rëndonte mbi Aristofanin), Sokrati e pranoi që demokracia kishte të drejtë ta vriste.

Vetëm mbas vdekjes athinasit e kuptuan se çfarë kishin humbur. Dhe frytet e revoltës nuk vonuan që të piquen. Kufomën e tij sapo e kishin zbritur në gropë dhe athinasit u ngritën kundër atyre që kishin provokuar dënimin e tij me vdekje. Disa prej tyre u vranë me gurë, të tjerët u çuan në mërgim. Ishte ky një fat, që duhet ta kenë parasysh të gjithë ata që bëhen të fortë me instinktet më të ulëta të popullit për të bërë padrejtësi kundër më të mirëve.

Sa për Sokratin, ai vazhdoi t’i qëndrojë mik Aristofanit, me gjithë talljet që i bënte në komeditë e tij. Sepse kjo ishte e bukura në Athinën e asaj kohe dhe shënja e qytetërimit të saj shumë të lartë. Por për momentin, le ta lemë të qetë të jetojë, të shëtisë dhe të flasë nëpër rrugët dhe sheshet e Athinës.

Synimi i tretë i Aristofanit ishte Euripidi. Dhe kuptohet. E urrente në mënyrë të tillë sa që vazhdoi t'i qepej e ta nxirrte në skenë duke e bërë nga figurat më meskine dhe më qesharake. Kjo gjë bile vazhdoi edhe mbasi kishte vdekur, sidomos në komedinë “Zogjtë”, që ndoshta ishte më perfektja nga punët e tij. Është thënë shpesh se Aristofani ishte një grumbull kontradiktash. Mbahej si kampion i virtytit, por e mbronte atë me një gjuhë të denjë për një faqezi dhe përdorte për këtë armët më imorale, si për shembull shpifjet dhe thashethemet. Pa dyshim ishte shumë inteligjent, por buzëqeshte rrallë dhe me një sarkazëm vulgar. Në sherret e tij kundër Perikliut dhe popullit shpeshherë përfundonte në nivelet më të ulëta të tipave që bëjnë spiunllëqe dhe shkrime anonime me urrejtje dhe mllefe që kalonin sensin e masës. Për ne ishte një përzierje e madhështisë dhe maskarallëkut, me mizerjen e një thashethemexhiu. Ishte një idealist dhe njëkohësisht një horr që fitonte para me artin e tij. Por me gjithë këto akuza të rënda që shprehëm, duhet të themi që nuk mund të kuptohet kurrë dhe asgjë nga Athina nëse nuk lexohet Aristofani, që është lavdërimi më i madh që mund t'i bëhet një shkrimtari. Nga shkrimet e tij kuptohet kronika e atij qyteti, zakonet, idetë që qarkullonin dhe veset që e fshikullonin. Aty mund të gjenden, bisedat e kafeneve dhe të rrugës të ruajtura me shumë besnikëri. Vetë komedia e satirës politike, vdiq përpara Aristofanit që e kishte themeluar. Në vitet e fundit, ishte penduar që e kishte përdorur atë satirë në dëm të regjimit politik të Perikliut që e kishte lejuar dhe që tashmë kishte vdekur edhe ai. Sepse liria është nga ato të mira, që vlerësohet vetëm atëherë kur e ke humbur a të mungon. Aristofani vdiq në vitin 385 p.e.r. dhe e përfundoi jetën duke shkruar disa komedi të lehta sentimentale. Duke i lexuar ato, dëfrehesh fare pak, sepse ndihet që edhe ai që i shkroi nuk u dëfrye aspak.

Jeta në Lesbo. Safoja

Mitilini, në ishullin e vogël të Lesbo-s u bë kryeqytet, ishte i famshëm për verërat e tij dhe për tërmetet. Ishulli i Lesbo-s ishte i paracaktuar nga vetë natyra që të bëhej mbartës i një qytetërimi të veçantë. Bregdeti i tij jugor shquan përtej detit ishullin e Kios, vendbanimin tradicional të Homerit dhe të homeridëve, të cilët recitonin eposin e Homerit dhe kompozonin për to prelude poetike në formë himnesh. Të dallueshme fare qartë nga Mitilini dhe nga gjithë bregu lindor i ishullit, janë brigjet e Azisë së Vogël, që prej shekullit VII p.e.r. kishin filluar të pranojnë influencën e mbretërve të Lidisë dhe të asimilonin, qoftë edhe në mënyrë të veçuar, sjelljet dhe mënyrat e saj perëndimore. Nga veriu i Azisë së Vogël gjendet kepi i Adramitit dhe Troja, në të cilën rapsodët grekë gjenin dhe këndonin veprat dhe bëmat e stërgjyshërve të tyre heroikë.

Në ndryshim me ishullin fqinj të Limnos-it dhe atij të Kios, Lesbo-ja zotëron një terren të pasur.

Ullishtat shtrihen deri tutje në majat e kodrave të larta. E pasur pa fund është edhe në burimet ujore natyrore, që rrjedhin përmes livadheve me rrapet e larta dhe bimësinë e dendur. Me ardhjen e pranverës toka këtu mbulohet nga lulet, orkideat, anemonet dhe tulipanët e egër. Akoma edhe sot ishulli e justifikon titullin “hirplotë” që i fali poeti nga ishulli i Kios, Homeri, që e shkroi në poezinë “Himn për Apollonin”. Banorët e ishullit, që ndihmoheshin nga deti me të gjitha të mirat, zhvilluan një jetë të gjallë dhe të pavarur, të bazuar në traditat e vjetra dhe që përqendrohej sidomos në kohërat heroike dhe në Luftën e Trojës. Siç thoshin ata, këtu i udhëhoqi Orest, i biri i Agamemnonit, banorët e parë. Në vitet e mëvonshme, familjet e fisnikëve mburrëshin për origjinën dhe prejardhjen e tyre nga burrat që dikur kishin luftuar për hatrin e

Helenës. Në një ambient që ofronte bollëk dhe siguri, shoqëria e Lesbo-sit arriti në nivelin më të lartë të zhvillimit të saj në shekullin VII dhe VI p.e.r. gjë që na e vërteton edhe krijimtaria poetike vendase.

Edhe ajo si të gjitha shtetet helenike e filloi jetën politike me një monarki, që u transformua më pas në një oligarki aristokratike, derisa një koalicion, që po e quajmë kështu borgjezësh dhe proletarësh, e përmbysi atë duke vendosur demokracinë nëpërmjet të njëjtit diktator. Ai ishte Pittaku i Mitilinit, (Πιττακός ο Μυτιληναίος), rreth 650-570 p.e.r. Ishte politikan dhe udhëheqësi ushtarak i Mitilinit, një ndër njerëzit e shquar të Greqisë së Lashtë, që më vonë pati nderin ta shohë veten të renditur përkrah Solonit në listën e “Shtatë të Urtëve”, që ishte çmimi Nobel i kohës, por siç thonë më serioz nga ky i sotmi. Ishte një njeri i ashpër, i guximshëm, i ndershëm dhe i frymëzuar nga qëllimet më të mira, por pa shumë hezitime në zgjedhjen e rrugëve për t’i realizuar. Ai nuk u kufizua vetëm me përjashtimin e “patricëve” nga pushteti, por i përjashtoi ata edhe nga vendi, duke i çuar shumë prej tyre në internim.

Dhe midis shumë të tjerëve ishin edhe dy poetë: njëri mashkull, Alkeu dhe tjetra femër, Safoja. Për internimin e Alkeut nuk hezitojmë të besojmë që ekzistonin shkaqe të forta politike. Ishte një i ri aristokrat, turbullues dhe zhurmëmadh, me talent në shkrimet shpifëse dhe sharjeve, që nëse do ta krahasoja këtu, do të thosha se ngjante me një lloj komisar të kuq të kohës së komunizmit. Ecte me gjoksin të fryrë dhe nuk e humbiste rastin që të bënte përshtypje në popull. Por, ashtu siç ndodh gjithmonë me mburravecët, kur erdhi fjala për të rrezikuar kokën e për të luftuar me të vërtetë, e flaku mburojën tej dhe ua mbathi këmbëve, e pati kurajën të kompozonte vetëm një poezi me lavdërime për gjestet e tij duke i paraqitur ato si tregues të urtësisë dhe të modestisë.

Internimi i bëri mirë sepse, i hoqi nga koka ato ambiciet politike, e mblodhi ca duke e detyruar të pranonte natyrën e tij, domethënë atë të një njeriu, që nuk ishte as për të udhëhequr, as për të vënë ligje e as për të luftuar, por ishte një krye letrar i ndërtuar më shumë për të lartësuar veprat e të tjerëve sesa për të bërë të vetat. Ishte një virtuoz i poezisë që krijoi një metrikë personale, që më pas, pikërisht prej tij, mori emrin metrika “Alkeike”.

Dhe ndoshta do të kishte kaluar në historinë e njerëzimit si poeti më i madh i epokës së tij, i treti mbas Homerit dhe Isiodit, nëse nuk do të kishte fatin e keq, që jetoj në të njëjtën kohë me shoqen e tij të internimit politik, Safon. Për këtë grua magjepsëse që u shfaq me aq famë, përmbi dy mijë e gjashtëqind vjet më parë, Platoni shkroi: “Thonë se ekzistojnë nëntë muza. Çfarë hutaqësh që janë! Kanë harruar Muzën e Dhjetë, poeten Safo të Lesbo-s!”.

Edhe Soloni (në greq. antike Σόλων, i transformuar në latinishten Sólōn; Athinë, 638 p.e.r.–558 p.e.r.) që ishte ligjvënës, jurist dhe qeveritar athinas, me prejardhje nga një familje fisnike që për poezinë ruante një keqardhje të brendshme sepse ishte e vetmja gjë që nuk mundi ta bënte mirë, kur nipi i tij Esecistiti i lexoi një prej poezive të saj, i tronditur nga sa dëgjoi, kishte thirrur: “Po qe se duhet të vdes, le të vdes tani!”. Nëse Homeri, në një përcaktim të përgjithshëm, ishte “poeti” i madh i lashtësisë, Safoja ishte poetja.

Safoja e mahniste kaq shumë Greqinë e Lashtë dhe Romën, sa që sot nuk jemi në gjendje të dallojmë brenda për brenda jetës së saj ngjarjet e vërteta nga mitet, apo të shohim qartë sesi jetoj dhe punoj. Po paraqesim këtu ato pak fakte të vërtetuara që lidhen me jetën e saj.

Edhe pse disa përkrahin mendimin se lindi në qytetin e vogël Eresit, atdheu i saj është Mitilini, kryeqyteti i Lesbo-s. I ati quhej Skamandrónimos, e ëma Kleis. Viti i lindjes nuk është fort i qartë.

Enciklopedia “Suda” na thotë: “γεγονυία κατά την μβ’ ὀλυμπιάδα”. Nëse me fjalën “γεγονυία” ka parasysh fjalën “e lindur” (përkth. e lindur gjatë olimpiadës së 42-të), atëherë datëlindja e saj do të vendosej në distancën kohore 612-609 p.e.r., por meqenëse fjala zakonisht përdoret në kuptimin “u rrit ose lulëzoi”, atëherë Safoja duhej të ishte më e madhe dhe pothuaj bashkëmoshatare me Alkeun dhe me Pittakun me të cilët pati lidhje. Prandaj datëlindjen e saj e vendosim në dhjetëvjeçarin 630 dhe 620 p.e.r. Rridhte nga një familje aristokrate dhe kishte tre vëllezër, Larikun, Eurigion dhe Karasin. I pari u bë oficer i presidencës, për të dytin njohim fare pak gjëra, kurse i treti ndërmoi një aktivitet tregtar me Egjiptin.

Që nga fundi i shekullit VII p.e.r. jeta e qytetit të Mitilinit ishte e turbulluar nga luftërat e ashpra politike, që në fazën e parë kishin sjellë fundin e familjes aristokrate të Pentilidëve, të cilët mburreshin vazhdimisht se ishin nipat e Agamemnonit (vinin nga Pentili, djali i pa ligjshëm i Orestit, që ishte djali i vetëm i Agamemnonit). Më pas, fuqia u mor nga një eksponent i familjes së Kleanaktidëve, nga tirani Melankro. Nga viti 612 p.e.r. u rrëzua edhe ai nga froni dhe më pas u vra gjatë një revolte të përgjakshme, që udhëhiqej nga Pittaku (ishte bashkëshorti i vajzës së fundit të familjes së Pentilideve). Për fjalorin “Suda” dhe Agamemnonin, do të shtojmë nga një paragraf në shënimet në fund të librit.

Prindërit e saj, që ishin fisnikë dhe të pasur, akoma të vogël e nisën për në shkollën më të mirë të Mitilinit, ku mori njohuritë e gjera të kohës duke e përfunduar atë pikërisht në kohën kur Pittaku niste me sukses karrierën e tij politike. Të ishte implikuar vërtet edhe ajo në komplotin për ta përmbysur diktatorin? Na duket pak e çuditshme. Edhe pse bënte pjesë në një ambient fisnikësh në të cilin gratë vlenin diçka dhe nuk ishin të detyruara

që të merreshin vetëm me tjerijen dhe punimet e leshit, me shpërndarjen e pjatave dhe punët e rëndomta të shtëpisë, ashtu siç ndodhte me “borgjezinë” e akoma më keq me “proletariatën”, ajo nuk na duket të ishte ndonjë intrigante politike. Ambiciet e saj duhej të ishin të një natyre krejt tjetër dhe më shumë femërore.

Nuk besojmë të ketë qenë shumë e bukur. E vogël nga trupi dhe e brishtë, ngjante si një zeshkane nga flokët, nga ngjyra e lëkurës dhe nga sytë e zi. Si një qymyr i ndezur, që digjte cilindo që i afrohej. Me një fjalë kishte atë që sot quhet sex-appeal dhe kishte në mendje atë “defektin” e mençurisë që te gratë dhe te fëmijët e vegjël krijon te të tjerët një magji që nuk i reziston dot. Vetë ajo e quante veten “një kokë të shkujdesur dhe të rrëmbyer” dhe pranonte se kishte një zemër fëminore. Sa për portretet e saj që gjënden në vazot e zbukurimit, në enë balte si dhe në monedhat e lashtësisë, pa dyshim që ato janë thjesht krijime të fantazisë së artistëve.

Ndoshta, më shumë se politika, ishte morali që e shtyu Pittakun t’i tregojë kufirin e Pirras një qyteti diku pranë. Diktatori, si të gjithë diktatorët, ishte i rreptë dhe Safoja diçka duhet të kishte bërë, ndonjë proçkë. Edhe pse nuk e donte fare Pittakun, mendojmë se kjo diçka nuk kishte lidhje me ndonjë komplot. Përkundrazi, dhe siç e thamë ndoshta lidhej me moralin e saj, pavarësisht nga përgjigjja dinjitoze dhe gjerësisht retorike që i kishte kthyer Alkeut kur ky i kishte shkruar një letër galante dhe të hijshme duke iu ankuar se turpi nuk e linte t’i thoshte ato çka kishte dëshirë për t’i thënë. “Mendoj, Alkeo, se njohja dhe miqësia jonë e vjetër na e bën të detyrueshëm sinqeritetin e plotë. Nëse dëshirat e tua, do të ishin të pastra dhe fisnike dhe gjuha jote e përshtatshme për t’i shprehur, asnjë turp nuk mund të të pengojë që t’i thuash.”

Por bëhej fjalë për letërsi, në mes dy personash që e dinin se shkrimet e tyre do të mbeteshin në histori te pasardhësit. Sepse

Alceu sa për turp, në realitet kishte fare pak. Kurse Safoja aspak. Ai kompozoi për nder të saj disa vargje e vjersha të ndritura si p.sh. vargun e mëposhtëm:

ἰώπλοκ' ἄγνα μελλιχόμειδε Ψάπφοι.

(E kurorëzuar me vjollca, e ëmbël buzëqeshura, hyjnorja Safo.)

Bëhet fjalë për lavdërimin më të lartë të mundshëm, sepse Safoja vendoset në mënyrë indirekte në vendin e një hyjnie, madje me Afërditën. Në asnjë vend tjetër nuk u përdor ky krahasim, sepse vetëm ajo iu afrua aq shumë një perëndie, prandaj ia vlen të nderohet me të njëjtin venerim. Por as poezitë e bukura nuk arritën dot t'ia kthenin mendjen. Dhe gjithçka aty mbaroi. Për më tepër, poetët nuk e kanë zakon të martohen në mes tyre. Kufizohen vetëm ta urrejnë njëri-tjetrin prej së largu.

Porsa ishte kthyer nga internimi i Pirras, Pittaku e internoi përsëri, këtë herë në Sicili. Me sa duket kësaj here, ishte shkaktare ajo vetë që e irritoi aq shumë Pittakun. Thonë se aludoi dhe ironizoi hapur dhe keqas në publik të gjerë, drejtësinë e qeverisjes së tij duke thënë: “Dhe që të mos ju shkojë fare në mendje se po ju bëjmë ndonjë padrejtësi, edhe ne që ju qeverisim do t’i paguajmë shtetit një lloj takse, domethënë, vetes tonë!”. Bëhej fjalë për një goditje poshtë zonës së lejuar, në atë që për Pittakun ishte vijë e kuqe demarkacioni dhe përbënte pikën e dobët të tij, sepse ndonëse i ashpër mendohej të qeveriste sa më me drejtësi. Në Sicili u martua me Kerkolin. Ishte një tregtar i pasur grek nga ishulli i Andros që jetonte atje, pikërisht ashtu siç ndodh gjithmonë me “divat” e të gjitha kohëve, që për burrë zgjedhin milionerin e nderuar. Me të pati një vajzë, së cilës i dha emrin e nënës së saj, Kleida: “Që nuk do ta ndërroja kurrë”, shkroi, “as

për të gjithë Lidian, dhe as për Lesbo-n e adhureshëm”. Mbas kësaj, pasaniku bëri edhe detyrën e tij të fundit si bashkëshort i mirë që ishte, e la vejushë dhe pronare të të gjithë pasurive të tij. “Kam nevojë për luksin njëlloj si edhe për diellin”, pranoi ajo në mënyrë të hapur. Dhe mundi të kthehej përsëri në Lesbo mbas pesë vjetësh internimi që të shijonte si njërën ashtu edhe tjetrën, e lirë, e pasur dhe pa detyrime bashkëshortore. Internimet nuk duket se lanë ndonjë gjurmë në poezitë e saj, as edhe më vonë kur ishte bërë e njohur. Me sa duket nga kjo situatë përfitoi gjerësisht. Në fillim, përveç vajzës iu përkushtua me dashuri prej nëne, vëllait të vogël Karasit. Por ai e zhgënjeu duke u dashuruar, siç thonë, me një oborrtare egjiptiane. Safoja, siç ishte një femër me natyrë emotive, pati një krizë xhelozie, e çori në fytyrë, dhe nuk deshë më që t’ia shihte sytë. Më pas themeloi një institut për vajza, në të cilin u regjistruan të gjitha ato të shoqërisë më të mirë të Mitilinit.

Ky grup femëror, nga enciklopedia “Suda” përcaktohet me emrin “Tiasos”, që ishte një shoqëri e kultit të shenjtë të Afërditës, të Muzave, dhe të Kariateve. Këtë fjalë ndërkohë, nuk e ndeshim kurrë në vargjet e Safos, kurse “nxënëset” që bënë pjesë në to vinin edhe nga zona mjaft të largëta të Helladës si p.sh.: Anaktoria nga Mileti, Gongila prej Kolofonit, Eunika nga Salamina etj.

Disa e kanë konsideruar “Tiasin” si një lloj shkolle ose “edukimore” për vajzat e rangut të lartë. Në realitet më shumë bëhej fjalë për një shoqëri të ngjashme me një lloj “konvikti”, pak a shumë me ato ku mblidheshin vajzat spartane, si dhe grupet e tjera të praktikuara në Greqinë e Lashtë, në mënyrë që të përgatiteshin sa më mirë për kalimin nga jeta e vajzërisë në atë të gruas së martuar.

Safoja i quante ato “Etere”, domethënë “shoqe”. Por meqenëse gjatë shekujve, ky argument është trajtuar gjerë e gjatë dhe në

format nga më të ndryshmet, le të bëjmë këtu një shkëputje të përkohshme nga komenti mbi Safon dhe të shohim se çfarë ishin këto eteret.

Eteret

Çdo gjë nisi nga vrojtimi i statujës së Afërditës të Milos (Venusi i Milos, Luvrë, Paris, e vitit 100 p.e.r., 2,02 metra e lartë, u gjet në ishullin grek Milos, të Egjeut në vitin 1820. Një oficer francez, Zhyl Sebastian-Cezar Dumont d'Urville, i bindi francezët të nguten që ta blejnë statujën. Dhe ashtu u bë. Më 8 Prill 1820, francezët e blenë nga një banor i Milos për 1000 grosh, që në atë kohë ishte një shumë e konsiderueshme). Statujës edhe pse i mungojnë të dy krahët, duke u nisur nga pozicioni në të cilin qëndron, studiuesit dhe historianët e artit besojnë se ajo paraqet një “etere” që tjerri leshin.

Për grekët e vjetër, tjerrija e leshit kishte një domethënie shumë të afërt me seksin, sepse ekzistonte mendimi që, me të njëjtën mënyrë me të cilën gratë nga asgjëja krijojnë, tërheqin dhe nxjerrin jashtë fillin, po ashtu nga hiçi “prodhojnë” edhe fëmijët, - shkruan Elisabet Wayland Barber's, në librin e saj “Puna e Gruas në 20.000 vitet e para”. Vazo të ndryshme dhe enë greke, na paraqesin shumë herë pornet që tjerri. Ishte kjo një veprimtari prodhuese, ndërsa prisnin klientët. “Me të njëjtën mënyrë siç seksi ishte biznes për pornet, po kështu ishte edhe tjerrija e leshit dhe thurja e pëlhurave”, shkruan historiania e artit Rachel Rozenzweig në librin “Adhurimi i Afërditës” më 2004.

Po të lemë mënjane Helenën, Klitemnestrën, Penelopin, Andromakën dhe disa gra të tjera që hynë në legjendat, të

vetmet gra që fituan një vend në historinë e Greqisë së Lashtë ishin Eteret, të cilat ishin diçka në mes të geishave japoneze dhe koketave parisiane. Përveç më të famshmes prej tyre, Aspasisë që ishte mësuese e filozofisë, dhe dashnore e Perikliut (në greqisht Περικλῆς, “I rrethuar nga lavdia”, lindi në Holargo, Athinë, 495, edhe sot një nga periferitë më të zgjedhura – vdiq në Athinë, 429 p.e.r.), që ishte një ndër politikanët, oratorët dhe udhëheqësit ushtarakë më të mëdhenj të lashtësisë, e që veproi gjatë periudhës së artë të Athinës, ndërmjet Luftërave persiane dhe Luftës së Peloponezit 431–404 p.e.r. Por për të do të flasim pak më gjatë diku tjetër, kur të gjejmë rastin. Aspasia u bë zonja e parë e vërtetë e Athinës, në sallonin intelektual të së cilës ajo diktonte ligjet. Por kemi edhe plot emra të tjerë që na janë përcjellë deri më sot nga poetët, memorialistët, dhe filozofët që patën shumë familjaritet me to dhe mburreshin pa mbajtur asnjë rezervë. Frina, për shembull, frymëzoi mjeshtrin e madh Praksitelin, skulptorin e famshëm të shekullit të 4-të p.e.r. dhe bashkëkohës i Fidias, i cili e dashuronte atë deri në dëshpërim. Ajo mbeti e famshme jo vetëm për bukurinë e saj, por edhe për zotësinë me të cilën e administronte dhe e sillte vërdallë atë.

Sa për Praksitelin e Athinës, ishte i biri i skulptorit të dëgjuar Kifisodotit të vjetrit, dhe skulptori më i famshëm i shekullit të 4-të p.e.r. Ai ishte i pari që gdhendi formën lakuriqe femërore në dimensione natyrale. Marrëdhënia e tij erotike me modelen e bukur, me eteren Frina, u bë objekt frymëzimi për një seri veprash arti në vitet që erdhën më pas, duke filluar nga piktura e Jean–Leon Gerome (Vesoul, 11 maj 1824 – Paris, 28 janar 1904), në operën komike me titull “Phryne” të kompozitorit organist dhe pianistit romantik Charles-Camille Saint-Saëns, Paris, 9 tetor 1835 - Algjeri 16 dhjetor 1921, dhe libret të Auge de Lassus dhe deri në teatrin e hijeve *Donnay*.

Praksiteli punonte kryesisht në mermer edhe pse disa nga veprat e tij më të bukura janë në bronz. Kishte veçorinë që veprat e tij, karakterizoheshin nga një delikatesë dhe ëmbëlsi e veçantë. Frina i kërkoi Praksitelit, që ndër skulpturat e përfunduara që kishte, t'i jepte asaj veprën e tij më të mirë, në shenjë dashurie. Praksiteli, që nuk i hapej askujt në këtë fushë, e lejoi të merrte cilën prej tyre të dëshironte. Por Frina e bukur, ishte edhe dinake. Mbasi nuk e dinte se cilën nga skulpturat e mermerta vlerësonte më shumë mjeshtri, pagoi një shërbëtor, që ndezi fshehurazi një zjarr në sallën e statujave. Pas kësaj shërbëtori doli duke rendur dhe duke bërtitur me të madhe “zotëri, ra zjarr në shtëpi”. Praksiteli u turr me nxitim në sallën plot tym, rrëmbeu me një frymë skulpturën “Satiri në pushim” dhe u përpoq që ta nxirrte jashtë. Por kur pa që zjarri që po digjej ishte fare i vogël dhe nxirrte më shumë tym, ndërsa te pragu i derës qëndronte Frina që buzëqeshte me ironi, Praksiteli kuptoi aty dredhinë e saj. Kështu Frina zgjodhi. Nuk i shfaqej kurrë përpara e veshur si çdo grua tjetër, por e mbuluar vetëm me një tyl të hollë. Dhe vetëm dy herë në vit, për festat e Eleusit (të mëshirës hyjnore) dhe atë të Poseidonit (perëndisë së deteve), shkonte për t'u larë në det krejt lakuriq, ndërkohë që e gjithë Athina, linte takim aty për ta parë. Ishte një reklamë vërtet e gjetur, që e lejoi ta mbante çmimin e saj shumë të lartë. Aq të lartë saqë një klient, mbasi e pagoi, më vonë e denoncoi në gjyq. Besojmë se ishte një proces i jashtëzakonshëm dhe i ndjekur me ankth nga i gjithë populli. Frina mbrohej prej Iperidit, një avokat i përlyer i kohës, i cili e frekuentonte edhe vetë. Këtij nuk iu desh të harxhonte shumë kohë me gojëtarinë e tij, sepse u mjaftua t'ia hiqte pelerinën e hollë të trupit për t'u treguar gjykatësve gjoksin e saj dhe gjithçka tjetër, për të cilat akuzuesi kishte paguar aq shtrenjtë. Gjyqtarët hapën sytë, bile e vështruan për një kohë të gjatë, sidomos ata më pleqtë dhe pastaj e lanë te lirë.

Një tjetër etere e përmendur ishte Klesidra, tek e cila ndjenja e administrimit të mirë ishte e gjallë. E quanin kështu sepse jepej me orë të tëra, por sapo mbaronte koha, nuk lejonte më zgjatje të mëtejshme siç bënte për shembull Ignatena, e cila i harxhoi të gjitha kursimet për vajzën e saj. Dhe mbasi e bëri atë mësuesen më të përmendur të asaj kohe, e jepte me qira për gjysmë milioni drakma vetëm për një natë. Por me gjithë këto që përmendëm këtu, të mos besohet që eteret ishin vetëm objekte shfrytëzimi dëshirash, të orientuara vetëm për të mbledhur para. Ose të paktën, ato nuk ia u ndiznin dëshirat meshkujve vetëm me format e tyre të bukura. Eteret ishin ndër gratë e kulturuara të Athinës klasike. Dhe është pikërisht për këtë arsye, që edhe pse ligji nuk ua njihte të drejtat civile dhe nuk i lejonte të futeshin në tempujt, me përjashtim të atij të perëndeshës Afërditë, të gjitha personazhet më të rëndësishme të politikës dhe të kulturës së Greqisë së Lashtë, i frekuentonin hapur ato dhe i mbanin në pëllëmbën e dorës.

Platoni (Athinë 427 p.e.r. – 347 p.e.r.), filozofi i madh i Athinës së lashtë, nxënësi më i njohur i Sokratit (për të cilin Ksanthipi, e shoqja grindavece, thoshte se ishte një plak matuf dhe analfabet!), dhe mësuesi i Aristotelit, kur lodhej nga filozofia, shkonte e çlodhej tek Arkeanasa. Dhe këtë e bënte shpesh, sepse deri në pleqërinë e thellë ishte qejfli dhe shoqërohej më shumë me të rinjtë, sesa me të moshuarit. Meqenëse Platoni edhe filozofia e tij janë mjaft të njohur edhe te ne, do të shtoj disa radhë këtu, për të dhe për të tjerët, në mënyrë që lexuesi ta ndjekë këtë kapitull më me interes. Platoni ishte njeri i bardhë e i ndritur, pa kurrfarë ligësie. Përkundrazi, rrezatonte një ngrohtësi të simpatisë njerëzore, dhe përveç faktit që shprehte ide të mëdha, dinte të tregonte edhe shumë histori të bukura. Ashtu si të gjithë njerëzit seriozë, edhe ai e kishte shumë të zhvilluar ndjenjën e humorit. Akademia që drejtonte i merrte pjesën dërmuese të

kohës. Ajo nuk ishte universiteti i parë i Europës, sikundër ka shkruar dikush. Ishte më parë ai i Pitagorës në Krotonë dhe ai i Isokratit në Athinë. Por sigurisht që Akademia e Platonit ishte një hap i madh përpara në organizimin e shkollës moderne. Kur nuk jepte mësim, dilte shëtitje me grupe të vogla nxënësish dhe i stërviste ata në artin e argumentimit. Nxënësit visheshin me rroba dhe kapela elegante, dhe kishin një mënyrë të tyren në veprimet, në të folur dhe në mbajtjen e bastunit, sepse ishin veçanërisht të seleksionuar në mes familjeve më me emër. Në soletën e mermertë përmbi portën ishte gdhendur shprehja: “Μεδεις αγεομετρος εισιτος” që përfaqësonte si të thuash “Të tregoni gjeometrinë që në hyrje”. Besoj se kishte një kuptim simbolik pitagorik, sepse gjeometria zinte në fakt bashkë me matematikën, pjesën më të madhe të mësimave. Më pas vinin astronomia, ligjet, muzika dhe etika. Në akademi pranoheshin edhe gratë sepse, Platoni ishte një mbrojtës i flaktë i të drejtave të tyre. Dhe temat e provimeve ishin të vështira si për shembull: “Përshkruani rregullat që udhëheqin lëvizjet e çrregullta në dukje të planetëve, duke i krahasuar ato me ligjet që drejtojnë veprimet njerëzore”. Edhe sot, vendi dhe periferia ku ndodhej Akademia e tij në Athinë, për aq sa ka mbetur prej saj, quhet Akademia e Platonit. Një ditë njëri nga nxënësit, e ftoi që të bëhej nuni i dasmës së tij. Edhe pse i kishte kaluar pak të tetëdhjetat, mjeshtri shkoi e mori pjesë në festë, bëri shaka me të rinjtë deri natën vonë, duke ngrënë e duke pirë nga recetat më të lashtat greke të gatimit, sardele të pjekura, të mbushura me hudhra dhe majdanoz e me gjethe dafine, me verën e ëmbël të Lesbo-s dhe plot të mira të tjera. Në një moment të caktuar ndjeu pak lodhje, dhe ndërsa festa dhe alegoria vazhdonte, u tërhoq në një cep të veçuar që të merrte një sy gjumë. Të nesërmen në mëngjes aty e gjetën të ngurosur. Kishte kaluar pa e kuptuar, nga gjumi

i përkohshëm në atë të përvetshëm. E gjithë Athina pa dallim, u mobilizua për ta përcjellë në banesën e fundit.

Edhe filozofi i lashtë Epikuri i viteve 341-270 p.e.r., pranonte se një pjesë të mirë të teorive të tij mbi dëshirat, ia u detyronte Danaes dhe Leonsias, të cilat i kishin dhënë atij variantet më elokumente të mundshme, si për shembull edhe për thënien: “οὐκ ἔστι δῆ᾽αῦται καλῶς οὐδὲ αἰλῶται ἄνοῦ ἢ ὅτω δέοῦμῃ ὑπὸκ ἔσω ἡδῆν”.

“Nuk është e mundur që dikush të jetojë i kënaqur, nëse nuk jeton urtë e në pajtim me ligjet dhe ndërgjegjen, sikundër nuk mundet të jetojë urtë, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjet, nëse nuk rron i kënaqur.” Po ashtu edhe për thënien tjetër “Ata që na qeverisin, bëjnë shumë gjëra që nuk na i thonë, dhe thonë shumë gjëra që nuk i bëjnë kurrë”.

Sofokliu, tragjediani i lashtësisë, autori i “Antigonës”, “Elektrës”, “Edipi mbret”, “Filoktiti” etj. (496-406 p.e.r. në Athinë), kishte një marrëdhënie të gjatë me Teoriden, dhe kur i mbushi të tetëdhjetat, filloi një marrëdhënie të re me Arkipan.

Kurse Mironi i madh, i biri i Eleuterit, autori i skulpturës “Hedhësi i diskut”, skulptori që u lavdërua më shumë në Athinë në vitet 480 deri në 440 p.e.r., i kërrusur tashmë nga pleqëria, kur pa që drejt studios së tij po vinte si modele Laida, e humbi mendjen fare dhe i ofroi asaj gjithçka kishte mbledhur deri atëherë, vetëm të qëndronte një natë të vetme me të. Dhe mbasi, siç kuptohet, ajo nuk pranoi, të nesërmen i shkreti njeri qethi mjekrën, ngjyrosi flokët, veshi një pelerinë rinore ngjyrë të kuqërreme dhe i shkoi fytyrës një dorë me ngjyrë rozë. “Ore mik, - i tha Laida plot ironi, - mos mbaj shpresë më kot se do të marrësh sot atë që nuk ia dhashë dje babait tënd.” Ishte një grua e jashtëzakonshme, dhe jo vetëm për bukurinë e saj, saqë shumë qytete të Greqisë grindeshin ashpër duke pretenduar se ajo kishte lindur në qytetin e tyre (në fakt

ishite nga Korinhti). Ajo ia refuzoi ofertat Demostenit, politikanit të Athinës dhe njëri nga oratorët më të mëdhenj të botës antike (384-322 p.e.r.). Ishte shumë i pasur, por edhe i shëmtuar. Që t'ia plotësonte kërkesën, ajo i kërkoj 5 milionë drakmes, ndërkohë që i jepej falas Aristipit, që nuk kishte asnjë grosh në xhep, vetëm sepse pëlqente filozofinë e tij. Vdiq në varfëri të plotë, pasi kishte shpenzuar gjithçka që kishte për zbukurimin e tempujve, në të cilat nuk kishte të drejtë të hynte, si dhe për të ndihmuar miqtë e saj që jetonin në varfëri. Athina ama, ia shpërbleu me funeral madhështor, që nuk e kishte bërë kurrë as për udhëheqësit më të mëdhenj të shtetit dhe as për gjeneralët më me fat. Edhe Frina, të cilën e përmendëm më lart, kishte të njëjtin pasion për bamirësi. Ndërmjet të tjerash, i kishte propozuar Tebës, qytetit të saj të lindjes, që t'i ndërtonte të gjitha muret rrethuese mbrojtëse, nëse do ta lejonin që të gdhendte në një vend poshtë tyre emrin e saj. Teba iu përgjigj se, nuk mund ta pranonte, pasi aty bëhej fjalë për një çështje dinjiteti. Dhe me dinjitet qëndroi, por pa mure.

Por eteret, nuk duhet të ngatërrohen me pornet e zakonshme, që endeshin në çdo qoshe të Athinës, dhe më me bollëk gjendeshin në lagjet e portit në Pire, sepse marinarët në të gjitha kohët ishin klientët e tyre më të mirë, në atë biznes të ulët. Më të shumtat prej tyre ishin gra nga vendet e lindjes, me rini shumë të shkurtër e me tule të varura që degradonin ngadalë pa ngritur krye, duke e lënë veten të shfrytëzoheshin nga padronet e shëmtuara e të mplakura, të liga dhe grindavece që i administronin. Vetëm ato që ia dilnin mbanë të mësonin pak sjellje të mira dhe të luanin melodi me flaut, e përmirësonin disi imazhin dhe situatën e tyre dhe bëheshin “aleutride”, gra që shkonin nëpër bankete dhe dëfrenin të pranishmit, dhe mbasi u eksitonin dëshirat, kuptohet që ua përmbushnin mbas gostisë. Nga një karrierë e tillë, duket se vinte edhe Aspasia, që siç e thamë ishte e dashura e Perikliut, por

rasti i saj ka mbetur i vetëm. Aspasia themeloi në Athinë kurse letërsie dhe filozofie, për të reja, por ato që i frekuentuan, iu desh të sfidojnë skandalin që plasi me gjyqin e saj dhe iniciativa nuk zgjati shumë. Për këtë gjyq do të flasim më vonë.

Safo

Vazhdojmë tani më tej me argumentin tonë mbi Safon. Safoja u mësonte vajzave muzikën, poezinë dhe vallëzimin, edukatën dhe sjelljet e holla dhe nga sa na kanë mbërritur deri më sot, ishte një mësuese e paarritshme. Por më pas filluan të qarkullojnë zëra mbi disa zakone të çuditshme që kishin depërtuar në shkollë, apo që vetë ajo i kishte futur aty. Kështu vazhdoi derisa një ditë, prindërit e njërës prej vajzave që quhej Atti, erdhën dhe të nxirë në fytyrë, e morën vajzën e tyre, që ishte pikërisht e preferuara e mësueses.

Për ne shqiptarët, këto lloj zakonesh, jo vetëm që janë të çuditshme por për shumicën dërmuese të papranueshme. Por në Greqinë e Lashtë ekzistonin dhe vazhdojnë të ekzistojnë edhe sot, (dhe jo vetëm aty) tendenca imituese të “shijeve” të paraardhësve dhe qarkullojnë plot mbrapshti të tilla në të dy gjinitë njerëzore, të konsideruara “normale”, që për botëkuptimin tonë janë anormale. Por kjo është një çështje krejt tjetër.

Kjo fatkeqësi për Safon që një fat i madh për poezinë, sepse dhimbja e ndarjes e frymëzoi poeten për disa nga vargjet më perfekt të lirikës të të gjitha kohëve. Poezia “Lamtumirë Atti” mbetet një model i singleritetit, e i çiltërsisë së frymëzimit për kthjelltësinë e formës, dhe tregon që fatkeqësisht për poezinë e bukur nuk janë aspak të domosdoshme vetëm ndjenjat e bukura. Në mundimet e saj të hidhura e t’ëmblla, ashtu siç i përcakton ajo vetë, secili nga ne mund të shohë të vetat.

Siç u ndodh shpeshherë edhe mëkatareve, Safoja pati një pleqëri plot dinjitet dhe gati të ndritur. Viti i vdekjes së saj nuk është i njohur. Sipas një legjende, të besuar dhe të mbledhur nga Ovidi (lat. Publius Ovidius Naso Sulmona, 20 mars 43 – Tomi, 18 p.e.r., ishte një poet i ndritur romak, ndër më të mëdhenjtë elegjiakë), ajo filloi të dashurojë përsëri meshkujt, humbi mendjen për një marinar të quajtur Faoni, që nuk iu përgjigj ndjenjave të saj dhe prej tij, vrau veten duke u hedhur nga një shkëmb i lartë i Leukadës. Më vonë, në shkëmbinjtë poshtë greminës nga ku thuhej se ishte hedhur, për të mos lënë asnjë gjurmë të trupit dhe për të vërtetuar kështu origjinën hyjnore, prej saj u gjetën vetëm brekët!. Për fat të keq ajo rrobë intime e nxjerrë në breg nga dallgët dhe e “urdhëruar” nga perëndia e detit Poseidoni, e kishte tradhtuar. Thonë se ishte hyjni, por perënditë brekët nuk i përdorin. Edhe Poseidoni, vetë, statujat e të cilit vizitohen në muzetë e Athinës, gjithmonë paraqitet lakuriq. Por një epilog i tillë banal, nuk mund t’i takonte Safos. Kjo gjetje na ngjan si një histori e Komedisë së Re, dhe ndoshta është e bazuar në keqkuptimin e disa vargjeve të saj, të cilat do t’i komentojmë më poshtë. Ndërsa ajo veshje dhe ngjarje, ndoshta i përkiste ndonjë heroine tjetër, ndonjëres nga prostitutat e oborreve që në ishullin e Lesbo-s gjendeshin me shumicë.

Një fragment i prozave të saj, i zbuluar në Egjipt, na e paraqet krejt të ndryshme, të qetësuar dhe të dorëzuar. Është përgjigjja që ajo i dha një pretendenti, mbas kërkesës që iu bë për martesë: “Nëse gjiri im do të mund të jepte akoma lëng dhe barku im frute, do të nisesha pa u dridhur drejt një shtrati të ri nusëror. Por koha tashmë ka gdhendur shumë rrudha mbi lëkurën time dhe dashuria nuk më nxit më me fshikullin e mundimeve të saj të ëmbla”.

Kurse në një copë tjetër, që u shpëtoi shekujve shkruan: “Në mënyrë të pandreqshme, ashtu si nata plot yje ndjek nga pas

perëndimin e purpurt, ashtu dhe vdekja ndjek çdo gjë të gjallë, dhe më në fund e arrin dhe e përpin atë me egërsi”.

Poezitë e saj u mblodhën nga filologët e qytetit të lashtë Aleksandria të Egjiptit (ku ndodhej edhe Biblioteka e famshme e Aleksandrisë), në nëntë libra të grupuar sipas strukturës metrike të poezive që përmbaheshin në to.

Por shekujt që pasuan qenë të ashpër me Safon, për arsye morale. Nëntëqind e pesëdhjetë vjet më parë Kisha e dënoi atë që t’i digjeshin në turrën e druve veprat e përmbledhura në ato nëntë vëllime.

Ishte fare rastësi që në mbarim të shekullit të 19-të, dy arkeologë anglezë Sir Artur Surridge Hunt (1871-1934) dhe Bernard Pyne Grenfeil (1869–1926), zbuluan më 1896 në Oksirinko të Egjiptit disa sarkofagë të mbështjellë me copa pergameni. Emri i qytetit të lashtë ka kuptimin, “qyteti i peshkut hundëhollë”. Dhe bëhej fjalë për një lloj peshku të lumit Nil, i species “mormyrid”, që, sipas mitologjisë egjiptiane, i hëngri organin seksual Osirit, perëndisë së botës së përtejme dhe të vdekjes. Në arabisht sot qyteti quhet El – Bahnasa dhe ndodhet rreth 160 km në jug-perëndim të Kairos nën administratën e kryeqendrës Al-Minya dhe është një nga vendet arkeologjike nga më të rëndësishmet të zbuluara. Thamë pra, që arkeologët zbuluan disa sarkofagë të mbështjellë me copa pergamene, në njërin prej të cilëve ishin akoma të lexueshëm rreth gjashtëqind vargje të Safos. Këtyre u shtohen edhe disa fragmente nga “οστρακον”, copa qeramike të ndryshme që ishin pjesë vazosh zbukuruese që përdoreshin nëpër shtëpitë e mbi të cilat shkruheshin vargjet e saj. Prej tyre, koleksioni i veçantë i datuar në shekullin e III p.e.r, ruhet sot në Bibliotekën Laurenciana të Firences.

Kjo është gjithçka që na ka mbetur prej saj, por është e mjaftueshme për ta renditur atë në mes poetëve më të mëdhenj të

njerëzimit, ndoshta më e madhja, edhe përtej shekullit të 6-të. Për më tepër të tillë dhe njëzëri e konsideruan bashkëkohësit dhe ajo çka është më e çuditshme, po ashtu njëzëri e pranuan edhe rivalët e saj.

Më 10 Maj 2014 gazeta angleze “Telegraph” bëri një sondazh të gjerë publik, dhe anketoj një numër të madh studiuesish, kritikësh dhe lexuesish, mbas të cilit botoi listën përfundimtare të 15 veprave më të mira klasike të historisë së njerëzimit në krye të të cilave, në vendin e parë dhe të dytë qëndronin “Iliada”, 775 p.e.r. dhe “Odiseu” 725 p.e.r. të Homerit; në vendin e tretë, “Metamorfoza” e Ovidit, 8 p.e.r.; në vendin e katërt “Simpoziumi” i Platonit 385 p.e.r.; në të pestin “Arti i Dashurisë” i Ovidit, 2 p.e.r.; në të gjashtin “Fedoni” i Platonit 385 p.e.r.; në të shtatin “Simpoziumi” i Ksenofondës 360 p.e.r. Në vendin e tetë qëndron “Poezi” të Safos, 612 p.e.r. duke lënë pas vepra të autorëve të ndritur, si: “Jetë Paralele” e Plutarkut 120 p.e.r., “Eneidën” e Virgjilit 19 p.e.r., “Rrëfime të shën Agostinit”, 398 p.e.r., “Natyra e Sendeve” të Lukrecit 55 p.e.r., “Vepra dhe Ditët” të Isiodit 750 p.e.r., “Histori” të Herodotit 450 p.e.r., dhe vepra “Bujqësore” të Virgjilit, 29 p.e.r.

Ndërmjet rivalëve të Safos, disa prej tyre ishin prej një stofi shumë të mirë si p.sh Mimnermi. Por ndoshta i vetmi që mund të krahasohej me të ishte Anakreonti, një artizan i shkëlqyer i rimës, por i privuar nga pasioni dhe nga vrulli lirik që përbënin magjinë e Safos. Pa dyshim që më poshtë, do të ndalemi mbi të për një koment të shkurtër historik dhe letrar.

Anakreonti lindi rreth vitit 570 p.e.r. në qytetin e Teos, që gjendej në Azinë e Vogël, i vendosur mbi bregdetin e Ionisë në veri të Efesit, rreth 40 kilometra në jug-perëndim të qytetit të sotëm Izmir, ose Smirne në afërsi të portit Sigaçik. Në vitin 545 u largua nga qyteti i lindjes nga frika dhe kërcënimi i pushtimit

persian dhe bashkë me shumë bashkëqytetarë të tjerë u vendos në Abdera, në brigjet e Thrakës. Nuk qëndroi për shumë kohë aty dhe kaloi në ishullin e Samos, në oborrin e tiranit Polikrati ku qëndroi deri në vitin 522 p.e.r. dhe mbas vdekjes së papritur të këtij të fundit u largua për në Athinë ku u prit me shumë nderime nga Iparku, i biri i Pisistratit dhe pasues i tij, që ishte mbrojtës i arteve. Kur tiranët u përzunë nga Athina, u stabilizua në Thesali, si i ftuar në oborrin e Alevadëve. Në vitet e fundit të jetës u kthye përsëri në qytetin e lindjes në Teo.

Anakreonti ishte një poet i oborrit, të cilit i pëlqente të qëndronte në mes të zotërinjve e të merrej me ta. Tërë jetën u kujdes përmbi të gjitha vetëm për një gjë, që të jetonte sa më mirë.

Dhe ia doli mbanë sepse jetoi deri në tetëdhjetë e pesë vjeç, e do t'i kishte kaluar të njëqindat nëse një bretkosë e vogël e ngjitur në një bistak rrushi nuk do t'i kishte mbetur në fyt dhe e mbyti. Që t'u shmangej pakënaqësive, nuk u angazhua kurrë dhe me asgjë; as me politikë e as me dashuri. Dhe pikërisht kjo e pengon poezinë e tij që të futet thellë në shpirtin e lexuesit. Ajo është e ndërtuar në mënyrë të përkryer nga pikëpamja metrike. Solli edhe një model të ri poezie, pikërisht atë të odeve “anakreontike”. Por, në ndryshim nga Safoja që e pagoi të gjithë frymëzimin e saj me shumë gëzime, por sidomos me shumë hidhërime dhe mundime sflitëse, për Anakreontin poezia përmbi të gjitha, në mos gjë tjetër, si ta them ishte vetëm një zanat. Thonë se kur u mplak, dashuroi me të vërtetë dhe njohu e kuptoi vuajtjen e xhelozisë. Por tashmë ishte tepër vonë për të rifreskuar muzën e tij të lehtë, egoizmi i të cilit e kishte penguar që të gërmonte në thellësinë e ndjenjave njerëzore. Vdiq rreth vitit 485 p.e.r. Më poshtë do të shtojmë diçka më shumë për Anakreontin dhe për poezitë e tij. Në vitet që pasuan, vepra e Safos u vlerësua përherë e më shumë si nga populli i thjeshtë, ashtu edhe akoma më tepër nga

poetët, tragjedianët, skulptorët dhe nga cilido tjetër që pati lidhje me gamën e gjerë e artit antik. Ky vlerësim njohu apogjeun e tij sidomos në periudhën e artë të Perikliut, kur lulëzuan si kurrë ndonjëherë letërsia, artet e bukura dhe filozofia me përfaqësues të tillë si Fidia, Sokrati, Aristoteli, Platoni, Aristofani si dhe të tre të mëdhenjtë e tragjedisë Sofokliu (që do të thotë, “i mençur dhe i nderuar”, Perikliu e kishte ministër të Thesarit dhe më 440 p.e.r. i dha spaletat e gjeneralit në komandën e një brigade në luftën kundër Samos), Euripidi (që Gëteja thoshte se as Shekspiri nuk i afrohej dot), dhe Eskili (mbi varrin e të cilit është gdhendur mbishkrimi “Këtu dergjet Eskili, trimërinë e të cilit e dëshmojnë pyjet e Maratonës dhe persianët me flokët e gjatë, të cilët e njohën mirë”. Është mbishkrimi që Eskili e diktoi vetë për varrin e tij, pak përpara se të vdiste. Siç kuptohet, për të nuk kishin rëndësi meritat si dramaturg përpara atyre si ushtar në fushën e luftës me mendimin që vetëm prej atyre do ta vlerësonin dhe admironin pasardhësit. Dhe si ushtar, siç thuhet ishte një ekzemplar i rrallë). Në funksion pra të plotësimit të këtij kuadri politiko-shoqëror dhe për të kuptuar më mirë psikologjinë që mbizotëronte në përgjithësi në Greqinë e Lashtë në vitet kur jetoi Safoja por edhe në vitet më pas, diku më lart thamë se për Perikliun dhe Aspasinë, do të shtonim disa radhë kur do të gjendej momenti i përshtatshëm. Na duket se vendi është këtu.

Perikliu

Fati më i madh që mund t’i qëllojë njeriut në këtë botë, është ai që të lindë në momentin e duhur. Ka shumë të ngjarë që çdo brez të ketë Napoleonët, Leninët, Maot, Zogollët dhe Enverët e tij, por nëse duhet të veprojnë në një shoqëri që nuk i pranon

sepse, ose është shumë e rreptë ose shumë e kalbur, atëherë në vend të pushtetit ata përfundojnë ose të lëkunden nga era në majë të trekëmbëshit, ose zakonisht në harresë. Kështu ndodhi dhe me Perikliun, që pati në anën e tij shumë rrethana të favorshme dhe ishte i pajisur me veti të përshtatshme për kohën e tij saqë historia, e cila i përulet gjithmonë fatit, përfundoi t'i japë emrin e tij periudhës më me lavdi të zhvillimit e të lulëzimit të jetës athinase, atë të “kohës së Perikliut” që ishte koha e artë e Athinës. Ishte i biri i Ksanthipit, një oficeri të marinës që në Salaminë fitoi spaletat e admiralit sepse komandoi flotën në betejën fitimtare të Mikales (në Shtator të 480 p.e.r. kundër flotës perse të komanduar nga Kserksi I); si dhe i Agaristeas, stërmbesa e Klitenit që solli më 508 p.e.r. reforma parlamentare të theksuara demokratike që u konsoliduan më vonë nga vetë Perikliu. Ishte pra një aristokrat, por ideologjikisht i lidhur më shumë me “Partinë Demokratike”, atë me një të ardhme më të sigurt. Diçka duhej ta kishte paracaktuar që në vogëli në pozicionin e radhës së parë, sepse që atëherë qarkullonte një legjendë mbi origjinën e tij që e bënte të mbinatyreshëm. Flitej se pak përpara se ta nxirrte në dritë nëna e tij, Agaristean e kishte vizituar në ëndërr një luan. Në realitet me luanin, Perikliu nuk kishte aspak ngjashmëri. Ishte shumë delikat dhe i brishtë, me një kokë në formën e theksuar si të dardhës, që ishte edhe shkaku që gjatë gjithë jetës nuk e pa kurrë njeri pa helmetë dhe që më vonë u bë shkak për gjuhët e liga dhe bejtexhijtë e Athinës për thashetheme dhe idiotizma të pafund. Por në familje që në fillim i dhanë një edukatë prej një princi trashëgimtar, dhe nga kjo ai përfitoi me shumë zell dhe inteligjencë. Strategjia, ekonomia, filozofia, literatura dhe historia ishin “buka” e tij e përditshme që ia ofronin mësuesit më të ndritur të Athinës në mes të të cilëve spikaste filozofi Anaksagora (miku i Sokratit), ndaj të cilit nxënësi i mbeti mirënjohës deri në fund.

Si fëmijë, Perikliu besohet të ketë qenë i pjekur para kohe, shumë serioz dhe i përfshirë nga ideja e rëndësisë së tij, me karakterin e theksuar të “të parit të klasës” që e bënë ta kishin inat moshatarët e tij. Sepse që nga momenti që hyri në politikë, dhe hyri shumë shpejt, nuk bëri asnjë nga gabimet që bëjnë zakonisht të rinjtë, në rrëmbim e sipër. Këtë e provon edhe emri që i vunë “Olimpik”, si nga ata që e deshën po ashtu dhe nga kundërshtarët, edhe pse nga këta me një fije ironie. Ekzistonte tek ai diçka që, siç thonë, dukej sikur pikonte nga qielli, ndoshta ishte mënyra sesi fliste që bënte aq përshtypje. Nuk ishte orator, as Demosten e as Ciceron, dhe as i dashuruar me fjalën e tij. Shumë rrallë mbante fjalime dhe këto brenda limiteve sa më të shkurtra. Pastaj mbante vesh, jo për t’u dehur, por për të kontrolluar vetveten. Fjalimet e tij nuk ishin për të entuziazmuar, por për të bindur. Kishin brenda tyre logjikën gjeometrike dhe të arkitekturës solemne të asaj periudhe. Nuk përmbanin pasione brenda. Kishin vetëm fakte, të dhëna, shifra, mendime dhe konkluzione. Perikliu ishte njeri i ndershëm që nuk abuzoi dhe doli nga politika me të njëjtën pasuri me të cilën kishte hyrë. Dhe ishte pikërisht për këtë korrektësi mendojmë, që athinasit nuk u lodhën së zgjedhuri atë në detyrat supreme për gati dyzet vjet me rradhë, që nga 467 deri në 428 p.e.r. dhe e njohën si strateg perandor dhe ofiqe të tjera që nuk i përmbante as Kushtetuta. Bëri një seri reformash në disnivelet ekonomike në mes klasave të ndryshme, futi në ushtri kompensimin në mënyrë që thirrja nën armë të mos përbënte rrënim ekonomik për familjet e varfra, përcaktoi një rrogë të vogël për pjesëtarët e jurive që kjo detyrë delikate të mos mbetej monopol vetëm i të pasurve. Zgjeroi të drejtën dhe dha nënshtetësinë për një kategori të gjerë personash që, për një arsye apo një tjetër, ishin përjashtuar nga kjo e drejtë, por imponoi ligjin apo e detyruan që ta impononte për një lloj racizmi që ndalonte njohjen ligjore të fëmijëve të lindur me

një të huaj. Ishte një masë absurde kjo, për të cilën më vonë do të duhej të bënte hesapet dhe të paguante haraçin edhe ai vetë.

Arma e tij më e fuqishme ishin punët publike, sepse në fund të fundit burrat e mëdhej janë edhe konstruktorë të mëdhenj dhe nga veprat duken. Ajo çka e dallon Perikliun nga të tjerët nuk është aq shumë volumni i madh sesa perfeksioni teknik dhe shija artistike me të cilat i kërkonte veprat. Por kishte edhe njerëzit që t'i realizonte; mjeshtrit, si Iktinoni, Fidiani, Mnesiklin me të cilët ndërtoi mbi Akropol Parthenonin, trashëgiminë arkitektonike dhe skulpturore më të madhe që Greqia antike i la botës. Edhe pse kujtonte se ishte i ftohtë, dhe ndoshta vërtetë ishte, si të gjithë njerëzit e pushtuar nga ambiciet politike, edhe Perikliu e pagoi një ditë taksën për më njerëzoren e të gjitha dobësive, për dashurinë, dhe humbi mendjen për një grua. Çështja ishte pak e koklavitur për dy arsye. Para së gjithash sepse ai ishte i martuar dhe deri atëherë kishte qëndruar si më i denji i bashkëshortëve dhe së dyti, ajo për të cilën u dalldis, ishte një e huaj me qëndrime dhe një të shkuar të diskutueshme. Aristofani, komediani më i madh i antikitetit dhe gjuha më e mprehët e Athinës, që ishte në fakt një përzierje në mes maskarallëkut dhe madhështisë (sepse ai që njëri nga shkaktarët kryesorë për dënimin me vdekje të Sokratit), thoshte për Aspasinë se kishte qenë një oborrtare e Milezit, ku administronte atje një shtëpi punësh të liga. Nuk janë gjetur dëshmi as ta vërtetojmë, e as ta mohojmë. Sidoqoftë mbasi u transferua në Athinë, hapi atje një shkollë jo shumë të ndryshme nga ajo që kishte themeluar Safoja në Lesbo. Aspasia nuk shkruante poezi, por ishte një intelektuale që luftonte për emancipimin e grave, për të drejta të barabarta me burrat dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën politike dhe shoqërore. Këto janë gjëra që sot i dëgjojmë dhe i përcjellim me indiferencë ose si diçka tashmë të zakonshme a normale, por për atë kohë ishin ide të mëdha revolucionare. Nuk dihet nëse ishte e bukur.

Ata që e ngrinin lart na flasin për zërin e saj “të argjendë”, flokët “të artë” dhe për këmbët e bukura, cilësi këto që mund të gjenden edhe në një grua të shëmtuar. Por, sa për magji, besoj se duhej ta kishte pasur me bollëk, sepse të gjithë këtu bien dakord dhe e lavdëronin për bashkëbisedimin dhe mënyrat e sjelljes. Dikush thotë se kur e njohu Perikliu, ajo kishte lidhje me Sokratin, ishte dashnorja e tij, por meqenëse ai nuk merakosej aq shumë për gratë e lëshoi me gjithë qejf dhe bashkë mbetën miq. (Për Sokratin, Platoni shkroi “Falënderoj Zotin që linda grek dhe jo barbar, që linda burrë dhe jo grua, që jam i lirë dhe jo skllav. Por përmbi të gjitha e falënderoj që linda në shekullin e Sokratit”).

Është e sigurt që salloni i Aspasisë frekuentohej nga njerëzit më me emër të Athinës. Vinin aty tragjediani Euripidi, udhëheqësi ushtarak që përçmonte paqen Alqiviadhi (ishte nxënës i Sokratit, i cili kishte shumë dashuri për të, një dashuri, për natyrën e së cilës ndoshta do të ishte më mirë që të mos gërmonim më tej), dhe Fidia, mjeshtri i madh në skulpturë. Ajo dinte t’i mbante të gjithë aq mirë sa që Sokrati pranoi, ndoshta duke e tepruar pak, se prej saj kishte . mësuar artin e argumentimit. Ishin pikërisht këto cilësitë intelektuale, më shumë sesa ato fizike, që e magjepsën Perikliun. Me sa duket, atëherë u kujtua që kishte dhe grua, sigurisht jo aq virtuoze sa e dashura, së cilës me shumë mirësjellje i ofroi divorcin, që ajo e pranoi. Kështu Aspasia u bë “zonja e parë e Athinës”, hapi edhe një sallon tjetër dhe nga biseda në bisedë i dha edhe një djalë. Por për fat të keq, Perikliu ishte autori i ligjit që ndalonte dhënien e nënshtetësisë fëmijëve që ishin frute të bashkimit me të huajt. Tani viktimja ishte ai vetë dhe e pranoi atë me shumë dinjitet. Aspasia e bëri të lumtur në jetë, por në politikë nuk i solli fat, sepse konservatorët edhe pse vazhduan t’ia jepnin votën, përbrenda nuk ia falën këtë veprim. Formalisht qëndroi strateg perandor deri më 428 p.e.r, vitin kur vdiq. Në fakt e kishte

humbur fuqinë që para tre vjetësh, domethënë, më 431, që kur ishte ngritur një gjyq kundër Aspasisë, qëllimi i vërtetë i të cilit, në realitet, ishte vetë ai. Qe ngjarja e madhe politike e momentit, me personazhe të shoqërisë së lartë, por me aspekte moralisht të pa denja dhe të ulëta. Akuza për. Aspasinë ishte, “për mungesë respekti ndaj hyjnive dhe parime morale të papranueshme”. Bashkë me Perikliun u goditën edhe shumë miq të tij të ngushtë si Anaksagora, Fidria, të cilët u arratisën për të evituar atë proces që nuk ishte i sigurt as për vetë Perikliun. Ishte njëlloj sikur të rihapje një varr. Aq e fortë ishte era e qelbur që doli nga ai proces në formën e pamfleteve dhe letrave anonime. E akuzuan për keq administrimin e financave dhe se ishte dorëlëshuar. Por Perikliu shpjegoi se ajo që e bëri të zgjidhej perandor për gati dyzet vjet me radhë kishte qenë pikërisht suksesi në administrimin e shtetit. Dhe shifrat ishin shifra, sepse gjatë udhëheqjes së tij, bilanci shtetëror kishte njohur vetëm rritje sepse nuk kishte abuzuar. Dhe kjo ishte më se e vërtetë. Nëse ai proces turpëronte dikë, ai nuk ishte Perikliu, as edhe Aspasia. Ishte vetë Athina. Për shkak të procesit të Aspasisë dhe të luftës së Athinës me Peloponezin kundër spartanëve që u mërzitej gjithmonë paqja, (sepse të gjithë e ëndërronin për veten e tyre, mbishkrimin mbi varrin e treqind spartanëve: “Shko udhëtar e i thuaj Spartës se ne ramë këtu të bindur ndaj ligjeve të saj”) luftë kjo që vazhdonte prej kohësh, Perikliu kishte vënë re se armiq të tij ishin shumëfishuar si nga e majta, me zejtarët dhe vegjëlënë e qytetit, ashtu edhe nga ana e djathtë me drejtuesit ushtarakë e të pasurit. Për më tepër, mbipopullimi i Athinës, që në bazë të shtrirjes thonë se numëronte gati gjysmë milioni banorë, kishte shkaktuar epideminë e tifos me hemorragji që po shkurtonte radhët e ushtrisë dhe popullin. Dhe siç ndodh zakonisht në këto raste, në vend që të kërkonin shkaqet e sëmundjes dhe të mikrobrit, athinasit kërkuan përgjegjësin, dhe

natyrisht këtu treguan me gisht Perikliun. Që ta krahasojmë atë gjyq në mënyrë simbolike me ngjarje të kohëve të sotme, ishte njëlloj nëse do të mund ta imagjinonim, me një proces gjyqësor kundër zonjës Hoxha, në kohën që Enveri ishte gjallë dhe në kulmin e fuqisë së tij. Kush e di nëse athinasit u kujtuan ndonjëherë për privilegjin e madh që u kishte qëlluar, të kishin lindur në Athinë në kohën e Perikliut. Ndoshta asnjëherë! Sepse njerëzit dinë të çmojnë dhe të masin vetëm fatin e të tjerëve. Të tyrin, kurrë. Kundërshtari i tij më i ashpër nga e majta ishte Kleoni, një lëkurë punues trashanik dhe llafazan, por edhe shumë kurajoz. Ai e akuzoi ashpër Perikliun për përvetësim. Dhe meqenëse Perikliu nuk mund të jepte llogari për shumën sekrete që u kishte dhënë udhëheqësve spartanë, duke tentuar që t'i bënte për vete, e shkarkuan dhe e gjobitën pikërisht kur epidemia po i vriste dy fëmijët e ligjshëm dhe të motrën. Në fakt Perikliu, që me nisjen e atij procesi të sajuar gjyqësor, donte të largohej nga pushteti. Ndoshta ajo çka i shkaktoi kaq dëshpërim, nuk ishte aq shumë rreziku që i kanosej njeriut që ai dashuronte përmbi çdo gjë në botë, sesa vetë ajo provë e mos mirënjohjes, e lakmisë së ulët, e inateve të shurdhëta dhe komplekseve të inferioritetit me të cilat shoqëria e Athinës jepte shfaqje në ato momente në dëm të një njeriu ndaj të cilit ajo, në mos për gjithçka, i detyrohej shumë. Ishte kjo arsyeja e vërtetë për të cilën që atëherë e më pas ai nuk deshi më të qëndronte në krye të jetës politike. Ajo eksperiencë e hidhur, ia kishte thyer besimin te demokracia, sepse siç thoshte: “Me kalimin e kohës, ajo u shndërrua në një inkubator që kllloçiste instinktët më të ulëta njerëzore”. Është e vërtetë që, të penduar, shumë shpejt athinasit e kërkuan të vinte përsëri në fuqi duke bërë për të një përjashtim nga ligji që kishte vendosur ai vetë. I dhanë të drejtën e qytetarisë djalit të vetëm, që kishte me Aspasinë. Por njeriu tashmë ishte i mbaruar moralisht, dhe vetëm pak muaj më

vonë mbaroi edhe fizikisht. Gjynah! Ishte një epilog i trishtuar për një karrierë kaq të lavdishme. E zëvendësoi Kleoni, që ishte antiteza e tij njerëzore. Aristoteli na thotë se ngjitej në tribunë me turi të varur dhe pa pikë respekti u fliste athinasve me një gjuhë vulgare dhe të ulët. Por ishte një gjeneral i mirë, sepse që nga dita që erdhi në fuqi, u bë e qartë për të gjithë athinasit, se lufta tashmë ishte në prag të derës. Ishte si të thuash konkretizimi i suksesshëm, dhe pikërisht këtu është vendi për ta përmendur, i atij sonetit të famshëm të Achillinit (Claudio Achillini, Bolonjë, 18 shtator 1574- Bolonjë, 1 tetor 1640, profesor i madh jurist, matematikan, filozof, poet dhe shkrimtar italian, studioi për mjekësi) që e shkroi në poezinë e tij për mbretin e Francës, Luigjin XIII: “Sudate o focchi a preparar metalli...” (“djersitni o zjarre që të përgatitsni metale!” - për luftën që po afrohej) i theu spartanët në Sfakteria, i hodhi poshtë kërkesat e tyre për paqe, i nënshtroi me egërsi të padëgjuar kryengritjet e shteteve vasale të Athinës sipas divizës: “Αν σε κρατήσουμε δεν κερδίζουμε τίποτα, αν σε σκοτώσουμε δεν χάνουμε τίποτα” (Po të të mbajmë gjallë nuk fitojmë gjë, po të të vrasim nuk humbasim asgjë), dhe në fund vdiq duke luftuar si luan kundër heroit spartan Brasidit. Që ta mbyllim këtë koment të shkurtër mbi Perikliun dhe Aspasinë, themi se në periudhën e tij Athina njohu zotërimin më të ndritur dhe të shpejtë, njëlloj si një meteorit që përfshiu të gjithë Greqinë, në një hapësirë kohe që zgjati më shumë se tre breza. Perikliu pati privilegjin të ishte i pranishëm në të gjithë këtë parabolë të jashtëzakonshme dhe t’i japë asaj emrin e tij. Edhe pse kjo histori mbaroi në një mënyrë të hidhur, shumë melankolike dhe me mosmirënjohje, prapëseprapë jeta e tij ishte nga ato më me fat që mund t’i qëllojë ndonjëherë një njeriu. Në përfundim të këtij shkrimi të shkurtër, themi se Greqia zhvilloi dhe përpunoi një qytetërim që nuk vdiq, sepse qytetërimet nuk vdesin kurrë. Ato vetëm emigrojnë dhe ndërrojnë

gjuhë e zakone nga njëri vend te tjetri. Gjatë procesit të rënies së Greqisë, një konsull romak, Emilio Paolo (230 p.e.r. - 160 p.e.r.) i quajtur “maqedonasi” për shkak të fitoreve të tij në luftërat maqedonase, transferoi në Romë një mijë intelektualë grekë. Në mes tyre ishte edhe historiani Polibi, që më pas u bë një nga frymëzuesit e liberalizmit romak. Kurse më 146 p.e.r., Senati romak emëroi Luçio Mummion, një tjetër konsull dhe ushtarak (një palo ushtar ky i stilit të vjetër, që nuk ruante asnjë nderim për qytetërimin grek), që të shtypte rezistencën e Greqisë. Dhe mbas fitores së tij mbi lidhjen akease, e plaçkiti dhe e rrafshoi me tokën qytetin e Korinthit, duke transferuar më parë, të gjitha veprat e artit në Romë. Sigurisht që të dy konsujt nuk e kuptonin se po e transformonin disfatën e Greqisë në fitore. Dhe ishte pikërisht ashtu sepse pak kohë më vonë, vetë romakët e kuptuan këtë dhe thanë: “Graecia capta ferum victorem cepit...”, - Greqia e mundur fitoi mbi barbarin fitimtar. Në fakt, edhe vetë Greqia e kishte gjetur më në fund atë qetësi që i përshtatej prej kohësh. Qetësinë e varrezave! Në atë lloj stafete siç është vetë historia, flaka e qytetërimit e popujve të përparuar, por në rënie, u besohet popujve të rinj të pagdhendur, por që kanë forcën për ta çuar përpara.

Është e pamundur të hartojmë këtu një inventar të plotë për ato që e gjithë bota i detyrohet Greqisë së Lashtë. Historiani dhe juristi anglez Sir Henry Sumner Maine (Kelso në Skoci, 1822 - Cannes, 1888), ka shkruar se, “Të gjithë ne jemi akoma një koloni e Greqisë sepse, me përjashtim të forcave të errëta të natyrës, gjithçka tjetër që zhvillohet dhe përparon sot në jetën e njeriut, është me origjinë greke”. Ndoshta ka pak teprim brenda në këtë pohim edhe në të tjerët, por askush nuk mund të mohojë që kontributi i saj ishte i pafund dhe, përmbi të gjitha, protagonistët ishin të shumtë, të zjarrtë dhe magjepsës. Shpresoj që edhe Safoja të mbesë e tillë, në mes faqeve të shkrimit tim modest.

POEZI

ἀερίων ἐπέων ἄχομαι ἀλλ' ὀνότων κ
[ἔ]γω τὸ ἄλλος ἐπιτ []μέζον· τί γὰρ
ἦνεμ [κ αἶ με τιμίαν ἐπόησαν ἔργα
τὰ σφᾶ̃ δοῖσαι κ μνάσεσθαι τινά φα
μι καὶ ὕστερον ἀμμέων.

Lavdërime qiellore

E nis këngën time për Bukurinë me lëvdata
qiellore, atë fjalë aq të ëmbël në dëgjim,
vetëm kërkoja; oh! ç'gjë më të madhe nga
sa Muzat më dhanë mund të kisha lypur;

Prej fuqisë së tyre më dhuruan, prandaj
them: ndoshta një hyjni tjetër në kohët e
e ardhshme, do të gjejë dikë që të kujtohet
edhe për mua.

ζὰ ἐλεξάμαν ὄναρ Κυπρογενη κ ἄγι
χέλυ διὰ φωνάεσσα κ δευτέ νυν ἄ
βραι Χάριτες καλλίκομοί τε Μοῖσαι κ
βροδοπάχεες ἄγναι Χάριτες δευτε Δίος
κόραι κ δεῦρο δηῦτε Μοῖσαι χρύσιον
λίποισαι κ ὀφθαλμοῖς δὲ μέλαις νύ
κτος ἄωρος κ καὶ ποθήω καὶ μάομαι
κ οὐκ οἶδ' ὅττι θέω · δίχα μοι τὰ νοίμ
ματα κ κὰτ ἔμον στάλαχμον...

Flisja në gjumë

Në gjumë, thotë, pashë sikur flisja me
perëndeshën Afërditë, eja pranë të lutem
këndo e nxirr tinguj ti lira hyjnore, Muza
me flokët e bukur dhe ju të ëmbla Karite,
të Zeusit bijat e vërteta me lëkurën trëndafil
të duarve, që shfaqeni nga pallati i juaj i artë,
dhe kur gjatë natës gjumi i mundimshëm
sytë m'i rëndon dhe mua më djeg dëshira
e ma ndez flakë tërë trupin, se çfarë kërkoj
as vetë s'e di, në mëdyshje është kjo mendja
ime dhe pikë-pikë brenda meje dhimbja pikon...

μίτε μοι μέλι μίτε μέλισσα κ τὸν
δ' ἐπιπλάζοντ' ἄνεμοι φέροιεν καὶ μελέ
δωναι κ ἀλλὰ τις οὐκ ἔμμι παλιγκό
των ὄργαν ἀλλ' ἀβάκην τὰν φρέν' ἔχω
κ ψαύην δ' οὐ δοκίμωμ' ὀράνω δυσπα
χέα κ ἦρ' ἔτι παρθενίας εἰβάλλομαι;.